



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë

**“Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe
qytetërim turk, përkthim dhe interpretim”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asoc. Dr. Monika Hasani

2. Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja

Mars 2023

Për Programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë , Letërsi dhe Qytetërim turk”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 259, datë 01.12.1998, por ASCAL nuk e disponon
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli 1
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/turqisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE/ 5 PAK v.a. 2020-2021 5 PAE/ 6 PAK v.a. 2019-2020 5 PAE/ 12 PAK v.a. 2018-2019
18	Numri i studentëve:	35 studentë v.a. 2020-2021 10 studentë v.a. 2019-2020 44 studentë v.a. 2018-2019
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Më 04 dhe 05 tetor 2022, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës për vlerësimin e programit të studimit të Ciklit të Parë “*Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim*”. Vlerësimi i këtij programi studimi bëhet për herë të parë nga ASCAL-i.

Për të kryer vlerësimin e programit të studimit GVJ u mbështet në RVB-në, bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës, si dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi.


Fillimisht mund të themi se është bërë një punë e përgjegjshme për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, për grumbullimin e të dhënave në shërbim të vlerësimit për akreditimin e programit. Ky aplikim është përvoja e parë për këtë departament, që mbulon programin e studimit. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitete dhe qartësi dhe me përpjekje që të pasqyrohen me vërtetësi, gjendja aktuale e cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ si dhe të infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur burime të nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse që disponon Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të Universitetit të Tiranës”.

Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ vëren se ka vend ende për përmirësim, veçanërisht të raportit të ngarkesës midis disiplinave të formimit bazë dhe disiplinave të tjera. Gjithashtu duhet një ngarkesë më e reduktuar për disa pedagogë, të cilët mbajnë disiplina jo të një natyre dhe të afërta.

Departamenti i GJSLLB, seksioni i Gjuhës Turke në Universitetin e Tiranës ka në përbërje staf akademik relativisht të ri, por të kualifikuar për të përballuar mirë kërkesat shkencore që shtrihon ky program studimi. GVJ-ja vërejt se stafit akademik duhet të jetë më i shtuar, në përmbushje të realizimit të programeve që departamenti ofron. Stafit akademik është përgjithësisht staf i ri, por me përpjekje për t’u kualifikuar dhe rritur në mënyrë të vazhdueshme nga pikëpamja akademike. Stafit dallohet për përfshirje në projekte e trajnime ndërkombëtare.


Veçori e këtij programi është se është unik në llojin e tij në universitetet shqiptare publike e jopublike dhe relativisht i ri. Si i tillë ky program përballlet me sfidat e zhvillimit, përhapjes dhe konsolidimit të vlerave të qëndrueshme të traditës filologjike turke.



Sfidë tjetër e programit është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi. Aktualisht ka 35 studentë në vitin e parë pra të regjistruar për vitin 2020-2021 me notë mesatare 7, për vitin 2019-2020 10 studentë me notë mesatare mbi 7. Ky është një problem i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe nuk e vuan vetëm ky departament, por të gjitha departamentet që ofrojnë programe studimi në fushat humane në universitetet shqiptare publike e jopublike në vend. Si rrjedhojë prej UT-së, prej Fakultetit të Gjuhëve të Huaja , ku bën pjesë ky departament, duhen hartuar politika më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për të rritur numrin e studentëve.

Megjithëse pas zhvillimit të këtij program studimi, Bachelor, studenti i ka të relativisht të kufizuara mundësitë e punësimit DGjSLLB, si dhe strukturat përkatëse të UT-së duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (Alumni) dhe të krijojnë databazën e Alumnit edhe në nivel departamenti.

Më datë 21.02.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/35 Prot., datë 21.02.2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1024/14 Prot., datë 02.03.2023 ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e DRVJ-së. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr. 92, datë 04.08.2022 në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Universiteti i Tiranës, dokumentacionin shoqëruar të raportit dhe në vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 04-05.10.2022. Po ashtu, grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Universitetin e Tiranës, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e ciklit të parë “*Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim*”. nën vlerësim, me anëtarët e departamentit, përfaqësues të zyrave menaxheriale dhe horizontale, si të burimeve njerëzore, sekretarisë mësimore, NJSBC, Bibliotekës, si dhe me studentë të programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga Prof. Asoc. Monika Hasani Hoshafi dhe Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja, ekspertë të gjuhësisë dhe letërsisë. Në punën e tij, GVJ u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Grupi studioi me shumë kujdes Raportin e vlerësimit të brendshëm të Departamentit të Gjuhëve Sllave Ballkanike/ Dega e Gjuhës Turke (shtator 2022), RVB-në për programin Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim turk” për t’u njohur paraprakisht me gjendjen dhe problematikën e programit. Bazuar në këtë informacion u hartua një draft paraprak i raportit të GVJ-së, shoqëruar me një seri pyetjesh që lindën gjatë studimit të tij. Gjatë vizitës dy ditore (04 dhe 05 Tetor 2022) pranë njësisë, pyetjet në fjalë iu adresuan personave përgjegjës. Përgjigjet e marra u bënë pjesë e dokumentit final të këtij raporti. Gjatë vizitës në IAL, GVJ mori kontakte dhe bisedoi me personat e poshtëshënuar;


- Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja
- Përgjegjësin e seksionit të Gjuhës Turke në Departamentin e GjSLLB
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit seksionit të Gjuhës Turke në Departamentin e GjSLLB
- Stafin akademik të efektiv dhe me kontratë
- Zyrën e Karrierës dhe Alumni

- Përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Karrierës
- Zyrën e Kurrikulave
- Takim me Drejtorinë e Kërkimit shkencor
- Studentë të programit të studimit nga tri vitet akademike
- Zyrën e Burimeve Njerëzore
- Sekretarinë mësimore

GVJ vizitoi mjediset e mësimnit dhe aktivitetit tjetër studentor në IAL (auditorë, laboratorë, biblioteka).

Ky raport pasqyron përmbledhtazi mendimet tona për programin. Ndonëse në tërësinë e vet raporti ynë konfirmon gjetjet kryesore të RVB-së, ndan qëndrime të ndryshme prej tij lidhur me aspekte të caktuara të gjendjes dhe shkallës së plotësimit të standardeve të cilësisë së programit.


Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft-raportin tek koordinatori teknik i ASCAL-it.



Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Universiteti i Tiranës është universitet publik, që ofron programe në të tre ciklet e studimit, duke u mundësuar studentëve një qasje të gjerë, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programet e studimit në UT kanë për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës dhe shkencës në shërbim të lirisë e diversitetit të mendimit, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.</p> <p>Bazuar në nenin 8 të Statutit të Universitetit të Tiranës, UT-ja vendos në bazë të mësimdhënies traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore e ato evropiane.</p> <p>Sipas nenit 4 të Statutit të Universitetit të Tiranës, UT synon të mbetet model i arsimit të lartë publik, i karakterizuar nga përgatitje akademike dhe kërkimi shkencor.</p> <p>Në këtë kuadër, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, ofron cikle studimesh me programe me profil kombëtar, që realizohen nëpërmjet studimeve, artikujve shkencorë dhe punime monografike.</p> <p><i>[ref: Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), evidenca 3, pika 2-4; Programet e lëndëve, evidenca 3].</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti i Tiranës është universitet publik, që realizon misionin e tij përmes: kërkimit shkencor, edukimit, si dhe shërbimit ndaj publikut, duke synuar edukim me në qendër studentin, si dhe nxitjen e rritjes personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetarë të përgjegjshëm në një shoqëri globale, bazuar këto dhe në nenin 5 të Statutit të UT. Ndërsa sipas nenit 4 të këtij statuti, Universiteti i Tiranës synon të angazhohet në transformimin e jetës së studentëve dhe të shoqërisë. Sipas “Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës”, zhvillimi i partneriteteve dhe i bashkëpunimeve afat-mesëm dhe afat-gjatë, rrisin vlerën kombëtare dhe ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës.</p> <p>Bazuar në kornizën konceptuale të programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Turke, ky program ofron një kurrikul bashkëkohore për të kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore.</p>



	[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 19; Strategjia e zhvillimit të Fakultetit (2021-2024), evidenca 51].		
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike ofron programe studimi sipas niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në harmonizim me misionin e Universitetit të Tiranës.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në përmbushje të objektivave strategjike të Universitetit të Tiranës, synon që të ofrojë edukim të nivelit të lartë mësimor e shkencor në Shqipëri në fushën e gjuhëve të huaja.</p> <p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 5: Misioni, evidenca 19; Strategjia e zhvillimit të Fakultetit (2021-2024), evidenca 51; Rregullorja e programit, neni 3, evidenca 8].</p>		
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Bazuar në “Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës”, dhënia e kontributit real në prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të aplikuar në UT realizohet në përfitueshmëri të ndërsjellë ndër aktorët e hapësirës akademike dhe të biznesit. Universiteti i Tiranës përmes programeve të studimit, synon t’i përgatisë studentët për konkurrencën në tregun e punës, duke ndikuar në krijimin e një pasurie shoqërore, që në tregun e punës të ketë një impakt pozitiv për zhvillimin kombëtar.</p> <p>Bazuar në RVB dhe vizitat e kryera në IAL, programet e studimit hartohen, përshtaten dhe përmirësohen në funksion të përmirësimit të potencialeve të rinisë për t’i shërbyer zhvillimit shoqëror.</p> <p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 19; vizita në institucion].</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në bazë të evidencave vihet re se Universiteti i Tiranës ka hartuar dokumente, ku përcaktohet orientimi për hartimin dhe zbatimin e programeve të studimit. Sipas raportit të GVB-së dhe Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), të gjitha programet e studimit në UT nxisin mendimin kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare që karakterizohet nga debat i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj të mirës publike.</p> <p>[Ref: Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), Pika 1, 1.2.12. Mësimdhënia dhe studimet, evidenca 1.4.; Rregullore e</p>

	<i>Programit te Studimit "Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim". evidenca 3.6.]</i>		
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Bazuar në Rregulloren e UT, versioni 2016, neni 31, programet e studimit në Universitetin e Tiranës hartohen nga vetë njësitë bazë akademike të universitetit dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p>Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, programi i studimit "Bachelor" në "Gjuhë Turke" është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit, burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë dhe statutin e rregulloren e Universitetit të Tiranës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë.</p> <p>[Ref: Rregullorja e Universitetit të Tiranës, evidenca 47; vizita në IAL].</p>		
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Programi i studimit në ciklin e parë "Bachelor" në "Gjuhë Turke" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, sipas standardeve ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p>Sipas evidencave kurrikula e programit është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në fushën e gjuhëve të huaja. Hartimi i programit të studimit, syllabusve të lëndëve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në vendin tonë dhe ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe veçanërisht Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike.</p> <p>[ref: Rregullorja e Universitetit të Tiranës, evidenca 47; Rregullore e Programit të Studimit, neni 3, evidenca 4].</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Programi i studimit "Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Oferta akademike e studimeve të ciklit të parë "Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim" është konceptuar për të formuar një brez të ri të formuar me një vështirësi objektive dhe kritik në shoqërinë në përgjithësi, për të ndikuar zhvillimet shoqërore dhe zhvillimet e politikave të ndryshme.</p> <p>Këto objektiva pasqyrohen gjithashtu në Rregulloren e Programit të Studimit.</p>

	Gjithashtu studentëve i bëhet e qartë misioni e objektivat formuese, si dhe kompetencat dhe aftësitë, që përftohen nga ndjekja e programit të studimit. Studentët përpara fillimit të procesit mësimor, marrin edhe trajnim për përdorimin e bibliotekës. [Ref: Rregullore e Programit të Studimit, Kreu II, neni 3, evidenca 8].			
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Bazuar dhe në RVB, institucioni kryen në mënyrë periodike studime mbi nevojat e tregut të punës për programet e studimit. Kështu Departamenti ka realizuar një studim tregu lokal e ndërkombëtar, ku në fakt është realizuar për hapjen e një programi Master në Mësuesi. Studimi përfshin të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. GVJ konstaton se duhet zhvilluar një studim i mirëfilltë tregu në lidhje me programin “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, për të gjetur dhe pikat e dobëta dhe zgjidhjet përkatëse në lidhje dhe me rënien e numrit të studentëve në këtë program studimi. [Ref: Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit të studimit, evidenca 17].			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Turke, si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave, që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. [Ref: Rregullorja e programit të studimit. Kreu II, Neni 3, Neni 4., evidenca 8].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Turke ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të cilët kanë gjithashtu përvojën dhe burimet akademike në fushën e gjuhëve të huaja. Departamenti në vitin akademik 2020-2021, kishte të angazhuar 5 lektorë me kohë të plotë, me grada e tituj shkencorë (3) Prof. Asoc. dhe (2) Dr., si dhe 5 personel akademik me kontratë (PAK), të cilët ofrojnë kapacitetet profesionale të mësimdhënies në programin e studimit “Bachelor”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>në “Gjuhë Turke”. Në këtë program studimi ishin të angazhuar gjithashtu edhe personel akademik efektiv i njësive të tjera bazë të UT, të cilët ofrojnë kapacitetet e tyre në funksion të mësimdhënies kryesisht në veprimtari formuese ndërdisiplinare dhe të përgjithshme.</p> <p>Përvoja e stafit akademik dhe kërkimi i tyre shkencor, bazuar në të dhënat e siguruara nga institucioni, vizita në IAL dhe RVB janë dëshmi e kapaciteteve akademike që Departamenti ofron për përmbushjen e qëllimit të ofrimit të ciklit të studimeve “Bachelor” në Gjuhë Turke.</p> <p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 19; Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2), evidenca 64; Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës sipas programit të studimit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, evidenca 3; CV-të e stafit akademik të programit të studimit, evidenca 20].</p>						
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe gjatë vizitës në institucion konstatoi se fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore, që është Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si dhe i shërben misionit të tij. Gjithashtu programi në fjalë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit dhe në shërbim të misionit të tij.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Turke është gjithashtu në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Evropiane dhe Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>[Ref: Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, neni 2, evidenca 44; Rregullore e Programit të Studimit, neni 2-3, evidenca 8].</p>						
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinare, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin përkatës, rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, atë të gjuhës dhe didaktikës. Bazuar te kurrikula e programit, syllabuset e lëndëve, CV-të e stafit mësimdhënës si dhe veprimtaria kërkimore e shkencore e realizuar në kuadër të programit, evidentohet, si në fushën akademike, ashtu edhe kërkimore, orientimi i zhvillimit të programit në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e njësisë bazë.</p> <p>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit, neni 2-3, evidenca 8].</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="638 1630 790 1697">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="790 1630 1005 1697">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1005 1630 1220 1697">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="638 1697 790 1740"></td> <td data-bbox="790 1697 1005 1740"></td> <td data-bbox="1005 1697 1220 1740" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ gjatë takimeve në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, konstaton se ka ndarje e zbatim të detyrave, të përcaktuara edhe me rregullore, të njësisve e personelit lidhur me organizimin e mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Bazuar dhe në intervistat e zhvilluara në IAL, u vërejt se analiza e punës së strukturave realizohet nëpërmjet treguesve të matshëm të realizimit të detyrave në formën e raportimeve tek drejtuesit e Departamentit ose Dekani, nëpërmjet takimeve periodike me titullarët, si dhe vlerësimit të performancës së pedagogut nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe përgjegjësve të njësisve të personelit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumenteve në dispozicion të GVJ, rezulton se njësitë bazë e përgjegjëse kanë të dokumentuar gjithashtu procedurat dhe analizat e vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p><i>[Ref: Raporti i veprimtarisë mësimore 2020-2021, evidenca 33; Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja; Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, evidenca 39; Manuali i cilësisë, evidenca 15].</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, IAL garanton cilësinë dhe ligjshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, që kontribuojnë në rritjen akademike të institucionit në përgjithësi dhe zhvillimin e profesionalizmit të stafit pedagogjik, duke siguruar në veçanti realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.</p> <p>GVJ bazuar në RVB dhe intervistat e kryera në IAL, konstaton se programi i Gjuhës Turke ka zhvilluar takime me ATTSO lidhur me punësimin e studentëve për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, duke vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si disa universitete në Turqi, Universiteti Bardin, Universiteti i Anadollit, Universiteti Çukurova dhe Universiteti Mehmet Akif Ersoy.</p> <p><i>[Ref: Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021, evidenca 35].</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në evidenca dhe takime në IAL, departamenti zhvillon një analizë pedagogjike, ku konsideron si objektiv strategjik zgjerimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve, si dhe mobilitetin e tyre në programet Erasmus +.</p> <p>Departamenti në përfundim të analizës vjetore vendos për prioritetet e vitit të arshshëm.</p> <p><i>[Ref: Raporti vjetor 2019-2020, 2020-2021, evidenca 35].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar RVB dhe takimet në institucion, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është në mbështetje të zhvillimit dhe bashkëpunimit me institucione të tjera, duke realizuar marrëveshje të ndryshme me</p>

natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>aktorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Megjithatë programi nuk parashikon praktikë mësimore për ciklin Bachelor.</p> <p><i>Për këtë GVJ sugjeron futjen e një lënde për praktikë mësimore në mënyrë që studentë të kenë mundësi kontakti me tregun e punës.</i></p> <p><i>Për këtë RVJ sugjeron futjen e një lënde për praktikë mësimore në mënyrë që studentë të kenë mundësi kontakti me tregun e punës.</i></p> <p><i>[Ref: Tabelat përmbledhëse, evidenca 53; minutat e intervistës].</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Bazuar në RVB dhe vizita në institucion, rezulton se nuk janë organizuar trajnime profesionale në bashkëpunim me punëdhënësit.</p> <p><i>GVJ sugjeron zhvillimin e trajnimeve profesionale dhe një kontakt më të ngushtë me tregun e punës.</i></p> <p><i>[Ref: minutat e intervistës].</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhën Turke”, rezulton se ky program studimi, me kohë të plotë është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi realizohet në formën e studimeve me kohë të plotë dhe përfundon me marrjen e diplomës. Siç është përcaktuar edhe në dokumentin mbi misionin dhe objektivat e programit, organizimi i tij “realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Ato realizohen në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhë Turke” ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<i>[Ref: Analiza vjetore e departamentit (2018-2019); Rregullore e programit të studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turke, Neni 4; Plani mësimor, evidenca nr. 3].</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Në dokumentacionin përkatës të programit, përcaktohet si objektiv kryesor i tij synimi të përgatisë specialistë të gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit turk të nivelit universitar të ciklit të parë, ku në përfundim të studimeve, të mund të konkurrojnë në tregun e punës për t'u përgatitur si specialistë, mësues, përkthyes/interpret, etj. Realizimi i programit të studimit, bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese, si dhe ato të natyrës praktike. <i>[Ref: Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë turke", neni 4, evidenca 1.8; Dosja e programit të studimit "Bachelor në gjuhën turke", Përshkrimi i programit, Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, Evidenca 1.4; Plani mësimor, evidenca 3].</i>
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Sipas RVB dhe rregullores së programit Bachelor në "Gjuhë Turke", planet mësimore e syllabuset e lëndëve, si dhe nga biseda me stafin akademik dhe studentët e diplomuar, rezulton se ky program synon të japë një qasje të zgjeruar dhe e të specializuar të koncepteve e çështjeve themelore në fushën e gjuhëve të huaja, si dhe fusha të tjera të lidhura me to e të përcaktuara në program si, gjuhë, letërsi, përkthim, komunikim, metodologji e mësimdhënie. Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë, letërsi, përkthim, komunikim, metodologji e mësimdhënies Turke" ka si mision të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të formuar specialistë në fushën e përkthimeve, mësuesisë, specialistë të komunikimit, të aftë të konkurojnë në treg, si dhe të përballen me kërkesat në rritje të tregut të punës. <i>[Ref: Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë Turke", evidenca 63; syllabuset e lëndëve, evidenca 66-174].</i>
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	RVJ konstaton nga intervistat me stafin akademik dhe studentët e këtij programi, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, evidentohet se programi përfshin në kurrikulën e vet lëndë, ku synohet që të diplomuarit të kenë një formim kulturor, shkencor dhe profesional në nivele të përparuar. Kompetencat e programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë Turke" lidhen me aftësimin e të diplomuarit për të ofruar shërbime profesionale në fushën e gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit turk, osmanishtes, etj. Programi gjithashtu ndihmon dhe siguron, që studentët të marrin njohuri dhe kompetenca në fushën e përkthimit, interpretimit dhe didaktikës. Nga intervistat me studentët rezulton se pedagogët ofrojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin e tyre akademik. <i>[Ref: Rregullore e Programit të studimit "Bachelor në gjuhë turke": Përshkrimi i programit/Objektivat formuese dhe karakteristikat e</i>

	<p><i>programit të studimit b) Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor: Programi akademik sipas kompetencave: Bachelor në gjuhë turke, evidenca 1.8].</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në dokumentacionin përkatës dhe syllabuset e lëndëve, programi i ciklit të parë në “Gjuhë Turke” i përmban të gjitha elementët, që përbëjnë strukturën e programit të studimit. Rregullorja mësimore e programit mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” e në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Struktura e studimeve për programin “Gjuhë Turke” përfshin: proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e punimit të diplomës/apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit dhe janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar, i cili vlerësohet nga një komision i ngritur për të. Disiplinat që zhvillohen në programin e gjuhës turke janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri të tjera formuese. Lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore, i ndarë në dy semestra. Me përfundimin e këtij programi studimi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja lëshon diplomë “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, të shoqëruar me suplementin e diplomës, referuar niveli 6 të “Kornizës Shqiptare të Kualifikimit”. [Ref: Programi lëndor (syllabuset) për “Bachelor në gjuhë turke”, evidenca 66-174; Diploma dhe suplementi. evidenca 52].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit e syllabuseve të lëndëve rezulton se në strukturën e programit gjejmë ndarjet e veprimtarive formuese, që ofrohen në këtë program studimi. Ato grupohen në kategoritë e përcaktuara të veprimtarive formuese, si: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese e detyrimet përmblylëse, me ngarkesën përkatëse në kredite, bazuar tek VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Gjithashtu, programet specifike të çdo lënde janë në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim dhe përfshijnë: pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin si dhe adresën elektronike të pedagogut. Në vazhdim janë: zëri i përmbledhjes dhe rezultatit të të nxënit, konceptet themelore, temat e lëndës, forma e kontrollit të dijes, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura si dhe zëri i vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës. Klasifikimi në programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhë Turke” sipas komponentëve mësimorë është: A. Për formimin e përgjithshëm kulturor e metodologjik – 18.33 % të planit mësimor;</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>B. Për përgatitjen Përgatitje për disiplinën shkencore – 52.5 % e planit mësimor;</p> <p>C. Në lëndët ndërdisiplinore/integruese, përfshihen nëndisiplina dhe lëndë me zgjedhje – 12.5 % të planit;</p> <p>D. Lëndët plotësuese përfshijnë 4 lëndë të planit, ose 11.33 % të tij.</p> <p>E. Lëndët përmbyllëse (provim/diplomë), 3.3 % të planit mësimor.</p> <p>[Ref.: Dosja e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”; Rregullore e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, neni 3; Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, pika 2].</p>		
Shkalla e përmbylljes së standardit	Përmbylljet pjesërisht	Përmbylljet kryesisht	Përmbylljet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyll kërkimet ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyll detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të institucionit dhe RVB, konstatohet se Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, përgjegjës për programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, përmbyll detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti, bashkërendon dhe administron veprimtaritë akademike, kërkimore dhe shkencore në respekt të lirisë akademike të stafit mesimdhënës.</p> <p>Bazuar verifikimeve të kryera nga GVJ, rezultojnë se NJSBC bashkëpunon me departamentin për përmbylljen e veprimtarisë vlerësuese dhe hartimit të raporteve për cilësinë e programit të studimit. Me propozim të njësisë bazë, ngrihen grupet e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit, të cilat miratohen dhe shpallen me vendim nga Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.</p> <p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 9, 10, 11, fq. 10-12, neni 23, pika 1 në ligjin nr. 80/2015, evidenca 19; Rregullore e Brendshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, neni 2, pika 1; Aneksi 1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), tituj/gradat: Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1.1 dhe 2.1), evidenca 43, 44; Rregullore e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, Kreu II, neni 3, Aneksi “Organigrama e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja”. Faqja web e FGJH-së, “Organigrama e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike”, evidenca 32].</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në</p>	<p>Bazuar në RVB ecuria dhe zhvillimi i programit “Bachelor në Gjuhë Turke” koordinohet mes përgjegjës të Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, koordinatorët e grupeve mësimore me karakter kërkimor-shkencor dhe koordinatorit për marrëdhëniet me studentët.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësise përkatëse.</p>	<p>Koordinatori për marrëdhëniet me studentët është përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve të Degës së Gjuhës Turke, i cili paraqet programin e studimit tek studentët dhe raporton problematikat e tyre tek përgjegjësi dhe në departament.</p> <p>Në analizën vjetore dhe mbledhjet e departamentit, raportohet për mbarëvajtjen e programit dhe të punës së tij, duke u ndalur në problemet që lidhen me stafin akademik, kurrikulën e mësimdhënien, shërbimet mësimore-studentore, administrimin, vlerësimin, programet akademike dhe kërkimore.</p> <p><i>[Ref: Statuti i UT-së, neni 38, neni 77 fq. 28, 45, evidenca 19; Rregullore e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, neni 5, 7, 8, 22, Aneksi "Organigrama e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike"; Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, neni 17, evidenca 43, 44].</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se, si njësia kryesore, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ashtu edhe njësia bazë, pjesë e strukturës së tij, Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, që ofron programin "Bachelor" në "Gjuhë Turke", përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti në fjalë funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe e punës kërkimore-shkencore të Fakultetit; ai nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore edhe lidhur me programin në fjalë.</p> <p>Departamenti mbledhet në mbledhje periodike, duke kryer funksionet e tij, përmbush kërkesat dhe standardet e cilësisë për organizimin e programit nga pikëpamja infrastrukturore dhe nevojat kryesore për strukturën akademike dhe për kualifikimet e stafit akademik.</p> <p>Departamenti krahas stafit akademik ka në përbërje edhe personel administrativ, që administron dhe mirëmban dokumentacionin arsimor. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij. Ai propozon edhe kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Arsimin e Lartë e akteve nënligjore. Departamenti për zgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësise kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit, si dhe të Fakultetit përkatës të Gjuhëve të Huaja.</p> <p><i>[Ref: Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin e I, II dhe III të studimeve, që ofrohen në njësine përgjegjëse (Tabelat 3.1, 3.2, 3.3, 3.4), Aneksi I, evidenca nr. 3; Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nenet 4, 5, 7 dhe 18, evidenca 44; Statuti i UT-së, neni 11, fq. 12; evidenca 19; Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), tituj/gradat: Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1.1 dhe 2.1); Grupet mësimore të Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, evidenca nr. 3].</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Programi “Bachelor” në “Gjuhë Turke” ka në përbërje të tij pesë lektorë me kohë të plotë me grada e tituj shkencorë, 2 Prof. Asoc. dhe 3 me titullin Doktor, si dhe katër lektorë të jashtëm. Lektorët mbulojnë lëndë në përputhje me kualifikimet dhe interesat e tyre të kërkimit shkencor. Departamenti përcakton kriteret dhe nevojat për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, si dhe i propozon dekanit të fakultetit kandidaturat për personel akademik me kohë të plotë, sipas listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc.</p> <p>Kështu Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, që është përgjegjëse për programin e studimit “Bachelor në gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk” përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (neni 25, pika 4). Departamenti ka gjithsej në dy programe, 10 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët 6 (gjashtë) profesorë të asociuar, 2 doktorë shkencash, si dhe 2 asistent-lektorë.</p> <p><i>[Ref: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat: Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1.1,1.2,1.3,1.4), Aneksi I, evidenca 3].</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, i përmbahet kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë, ku struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin, rregulloren dhe aktet e tjera të institucionit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, si njësia përgjegjëse për programin e studimit, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, ka dy degë: Dega e gjuhës ruse dhe dega e gjuhës turke dhe personel akademik me kohë të plotë, ku dega e gjuhës turke ka gjithsej 5 anëtarë, nga të cilët 3 profesorë të asociuar, 2 doktorë shkencash dhe 4 asistentë, ndërsa dega e gjuhës ruse ka gjithsej 5 anëtarë, nga të cilët 3 profesorë të asociuar, 1 doktor shkencash dhe 1 asistent-lektor.</p> <p>Në strukturën e departamentit shërben personel ndihmës akademik, si dhe personel përkatës administrativ.</p> <p>Përgjegjësitë dhe kompetencat e departamentit janë të përcaktuara në aktet dhe rregulloren e brendshme të UT dhe Rregulloren e FGJH në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë.</p> <p>Njësia bazë koordinon punën më njësinë përgjegjëse për të përmbushur detyrimet e organizimit të strukturës akademike.</p> <p><i>[Ref: Të dhënat tabelore për numrin e programeve në ciklin e I, II dhe III të studimeve, që ofrohen në njësinë përgjegjëse (Tabelat 3.1, 3.2, 3.3, 3.4), Aneksi I; Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nenet 4, 5 dhe 18, evidenca 44; Statuti i UT-së, neni 11, fq. 12, evidenca 19; Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë. Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat:</i></p>

	<i>Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4), Aneksi I, evidenca 3].</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se bazuar në dokumentacionin në dispozicion, institucioni disponon informacionet e nevojshme mbi programin e studimit, strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e saj. Departamenti ka 5 lektorë PAE, ku 3 prej tyre Prof. Asoc. dhe 2 me gradën Dr., si dhe 5 PAK me master shkencor. Rregullorja e fakultetit, departamentit dhe e programit të studimit, misioni e plani strategjik për programin, rregullorja e diplomimit, planet mësimore me syllabuset përkatëse të lëndëve, marrëveshjet me institucionet dhe organizatat bashkëpunuese e partnerët, rregullorja e provimeve, transferimeve, praktikës, informacionet për trajnimet e studentëve e aktivitetet ekstrakurrikulare, si dhe mundësitë e orientimit dhe këshillimit për karrierë, etj. janë pjesë e dokumentacionit që disponon departamenti, i cili është përgjegjës në organizimin e strukturës dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Njësia disponon gjithashtu informacione nëpërmjet ngarkesës mësimore, planit të punës dhe programin e aktiviteteve të programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”. Në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, programi “Bachelor” në “Gjuhë Turke” është organizuar në veprimtari formuese, të grupuara në lëndë bazë të programit të studimit, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, praktikë profesionale e detyrime përmbajtëse. Disiplinat grupohen mbi bazën e objektivave të tyre formuese, duke respektuar raportet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Sipas rregullores së programit, veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet mësimit në auditor (leksione, seminare, ushtrime), studimit individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e punimit të diplomës/provim formimi) dhe praktika profesionale. Në planin mësimor të programit përcaktohen lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, në vite e semestra, me kreditet përkatëse. Klasifikimi sipas komponentëve mësimorë për programin “Bachelor në Gjuhë Turke” për vitin akademik 2019-2020 është:
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

- Lëndë bazë (33 kredite, ose 18%)
- Lëndë karakterizuese (94.5 kredite, ose 53 %)
- Lëndë ndërdisiplinore (22,5 kredite, ose 13 %)
- Lëndë plotësuese (24 kredite, ose 13%)
- Detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3 %).
- Gjithsej 180 kredite ECTS.

Lëndët dhe modulet e programit janë të vlerësuara më kredite, sipas sistemit vendas dhe evropian, të ndara në 6 semestra me kohëzgjatjen 3 vjeçare e që plotësojnë numrin total të 180 krediteve evropiane (ECTS). Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite dhe 1.500 orë mësimore, ndërsa 2700 orë janë të përcaktuara si orë jashtë auditorit.

Nga shqyrtimi i rregullores e planit mësimor të programit Bachelor” në “Gjuhë Turke”, GVJ vëren se në to përmbahet informacioni i duhur për ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit. Programi mësimor i lëndës, jep në formë të përmbledhur strukturën e lëndës; përmbajtjen, orët përkatëse në auditor, duke i specifikuar në leksione dhe seminare, njohuritë paraprake të nevojshme për ndjekjen e lëndës, kushtet e veçanta në lidhje me frekuentimin dhe shlyerjen e detyrimeve para formës përfundimtare të vlerësimit. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës e miratohet, pasi konsultohet në departament.

Studentët mund të marrin gjithashtu të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të tyre.

Formati i syllabusit të lëndës dokumenton në mënyrë të detajuar informacionin mbi rezultatet e pritshme të të nxëniet në përputhje me formatet e miratuara, sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe ndryshimet përkatëse.

GVJ konstaton gjithashtu se rregullorja e programit të studimit parashikon rishikim në mënyrë periodike të programit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm. Para fillimit të vitit të ri akademik bëhet po ashtu rishikimi i programeve, ku synohet të korrigjohen problemet, që janë ndeshur gjatë procesit mësimor, duke përmirësuar dhe përditësuar elementë të ndryshëm të programit.

[Ref: Plani mësimor “Bachelor në gjuhë turke”, Aneksi I. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) (Tabela 9, 10), evidenca 3; Programi lëndor (syllabuset) për “Bachelor në gjuhë turke”, evidenca 66-174; Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”: Diploma dhe suplementi, evidenca 52; Rregullore e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, neni 1; Statuti i UT-së, neni 67/1, fq. 41-42, evidenca 19; Rregullore e UT-së, Kreu V, neni 39, 44; Kreu VI, Neni 56, 58; Kriteret dhe kuotat e pranimit,

	<p><i>Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike; Kuotat e pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në gjuhë turke; Kuotat e pranimit</i> https://unitir.edu.al <i>Fletëpalosja dhe guida e studentit, Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike 2019-2020; Shembull përmirësimi silabusi; Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (Tabela 11), Aneksi I, evidenca nr. 3;</i> <i>Faqja web e departamentit është jashtë funksioni:</i> https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-sllavo-ballkanike/ <i>GVJ sugjeron aktivizimin e faqes në mënyrë që të aksesohet sa më lehtë informacioni rreth departamentit dhe programit të studimit].</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumenteve të dorëzuara, GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit “Bachelor” në “Gjuhë Turke” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, ku programi është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 180 ECTS; - 6 semestra, 2 në çdo vit. <p>Plani mësimor i programit është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Rregulloren e posaçme të programit dhe Kalendarin Akademik të IAL. Organizimi i programit realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual. Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite. Programi i studimit “Bachelor” në “Gjuhë Turke” realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike. Në përlllogaritjen e orëve të kreditit përfshihen edhe koha për përgatitje dhe punë të pavarur të studentit. Ngarkesa e përgjithshme vjetore është jo më pak se 1500 orë.</p> <p>Sipas RVB, dega gjuhë turke, rezulton se çdo semestër zgjat 13 javë, ndërsa ngarkesa javore është deri 20 orë mësimore me kohëzgjatje prej 50 minutash.</p> <p>[Ref: Rregullore e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, neni 1; Kalendari akademik].</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë njohuri dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Struktura e studimeve për programin “Bachelor” në “Gjuhë Turke” përfshin: proces mësimor, përgatitje e punimit të diplomës/apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit. Ato janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Disiplinat që zhvillohen në programin “Gjuhë Turke” janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri të tjera formuese.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, nenet 2, 3 dhe 4; Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit/ b) Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor; Studimi i tregut të punës për programin “Bachelor në gjuhë turke”, fq. 12-14].</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se shpërndarja e lëndëve në vite e semestra, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> <p>Lëndët e detyrueshme janë vlerësuar me 6 kredite, duke ruajtur një raport të barabartë teori-praktikë (3 orë leksion e 3 orë seminar). Lëndët me zgjedhje, apo të formimit plotësues janë vlerësuar me 6 ose 4 kredite. Lëndët e vitit të parë janë ato bazë dhe plotësuese, lëndët e vitit të dytë janë lëndë karakterizuese, ndërsa në vitin e tretë, janë lëndë karakterizuese dhe integruese, të cilat thellojnë formimin shkencor dhe japin formim profesional në komunikim, përkthim dhe mësimdhënie. Shpërndarja e lëndëve sipas viteve akademike dhe semestrave, vihet re se i shërben objektivave arsimore të programit, të cilat njohja e mirë e gjuhës turke për të nxjerrë mësues, përkthyes dhe studiues të gjuhës turke.</p> <p><i>[Ref: Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, evidenca I.8; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, evidenca nr. 3].</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, GVJ konstaton, se kurrikula e programit, syllabusët dhe planet mësimore të tre viteve, struktura e tij, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite dhe raporti teori praktikë janë hartuar bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e</p>

	<p>arsimit të lartë”, Shtojca nr. 1, Tab. nr. 1, i ndryshuar. Ato janë në përputhje e me synim të realizimit të objektivave të programit.</p> <p>Të gjitha lëndët janë të pajisura me tekste përkatëse origjinale, të përkthyer ose leksione të përgatitura nga pedagogu i lëndës, ku studentët gjejnë parashtrimet themelore për lëndën. Përpos teksteve, studentëve iu referohet literaturë plotësuese.</p> <p>[Ref: Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, evidenca I.8; Rregullore e Programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, neni 1, 2, 3, 6 dhe 7, evidenca I.4; Ligji nr. 10 247, datë 4.03.2010, fq. 8-9.</p> <p>EQF – European Qualifications Framework (Kuatrid Evropian i Kualifikimeve)</p> <p>https://ee.europa.eu/ploteus/en/content/descriptors-page.</p> <p>Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9 dhe 10), Aneksi I, evidenca nr. 3].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës mbi programin, rezulton se organizimi i tij sipas llojit të veprimtarive formuese (A, B, C, D, E) me lëndët bazë të formimit të përgjithshëm e përgatitjes metodologjike, lëndët e formimit specifik, ndërdisiplinore e integruese; të veprimtarisë praktike e detyrimeve përmbyllëse etj. dhe përcaktimi i raporteve midis formimit teorik dhe praktik i shërben arritjes së objektivave formuese, transferimit të studimeve, mobilitetit dhe punësimit në përfundim të studimeve. Vendorsja në kurrikulën e programit të disa lëndëve dhe nga shkencat e tjera shoqërore u shërben objektivave më të gjëra të programit.</p> <p>[Ref: Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, Përshkrimi i programit, Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit, Programi akademik sipas kompetencave: Bachelor në gjuhë turke, fq.5, evidenca I.8; Procedurë njohjeje dhe ekuivalentim lëndësh, evidenca II.9, Shembuj marrëveshjesh ndërinstucionale dhe marrëveshjesh stafi dhe student në fushën që mbulon programin, evidenca 16; Studim i tregut të punës për programin “Bachelor në gjuhë turke”, fq.12-13, evidenca I.10].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, vizita në Bibliotekën e Fakultetit e biseda me stafin pedagogjik të programit, GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen për gjatë tre viteve akademike në programin Bachelor në “Gjuhë Turke” bazohen në literaturë të detyruar e ndihmëse edhe të viteve të fundit. Vetë institucioni disponon një bibliotekë në shërbim të programit, ku gjenden dhe libra në turqisht, të cilët i vijnë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Në tërësi, përmbajtja e lëndëve dhe syllabuset përditësohen, si një kusht i detyruar i vënë nga departamenti. Në programin e studimit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, programet lëndore miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani dhe dorëzohen në departament.</p> <p>[Ref: Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”: Përshkrimi i programit, Objektivat formuese dhe karakteristikat, evidenca I.8; Procedurë njohjeje dhe ekuivalentim lëndësh, evidenca</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>II.9; Shembuj marrëveshesh ndërinstitucionale dhe marrëveshesh stafi dhe student në fushën që mbulon programi, evidenca 16; Studim i tregut të punës për programin “Bachelor në gjuhë turke”, fq.12-13, evidenca I.10].</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Nga biseda me përgjegjës të departamentit, stafin akademik të programit dhe studentët, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke” garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Kjo del në pah nga shqyrtimi i organizimit të kurrikulës, përmbajtjes së lëndëve, literaturës, aktiviteteve kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, që shoqërojnë formimin e përgatitjen e studentëve përgjatë tre viteve akademike.</p> <p>[Ref: Rregullore e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, neni 2, evidenca I.2; Dosja e programit të studimit “Bachelor në gjuhë turke”, Përshkrimi i programit, Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit, Programi akademik sipas kompetencave: Bachelor në gjuhë turke, fq.4-5, evidenca I.8; Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, neni 5, evidenca I.2; Programi lëndor (silabuset) për “Bachelor në gjuhë turke”, evidenca 66-174].</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në RVB, intervista në institucion dhe evidenca, rezulton se përmbajtja e programit “Bachelor në gjuhë turke” mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë në programe “Master i Shkencave” dhe “Master profesional”. Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike ofron këto programe master: “Master Profesional” në “Mësuesi për gjuhë turke”, “Master i shkencave në Komunikim Ndërkulturor” dhe një program “Master i shkencave” në “Përkthim-Interpretim”.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Gjuha turke, për shkak të pranisë së bizneseve turke në vend, mësimdhënies së gjuhës turke në arsimin publik/privat, nevojës për përkthime të dokumenteve kryesisht për institucione dhe turq që banojnë në Shqipëri, pranisë së turistëve turq etj. rrit mundësinë e punësimit.</p> <p>Gjithashtu nga takimet me dekanin dhe përgjegjës të departamentit, si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se programi është konceptuar i organizuar për të mundësuar vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Zhvillimet e reja në tregun e punës kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulave mësimore me aftësitë, që kërkon tregu. Njësia bazë ka kryer gjithashtu edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre, si dhe përputhjen me nevojat e tregut.</p> <p>Nga biseda e GVJ me drejtuesit e departamentit e stafin pedagogjik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit është në vëmendjen dhe objektivat e departamentit, duke përfshirë edhe rrjetin Alumni.</p> <p>Bazuar në RVB dhe intervista, NJSBC në bashkëpunim me Drejtorinë e Edukimit, Drejtorinë e Komunikimit, Burimeve Njerëzore dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>fakultetet respektive ka organizuar ëorkshopin me temë “Studentët dhe tregu i punës” me qëllim përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve dhe Alumnit.</p> <p>[Ref: Organigrama e programeve të studimit, evidenca I.25; workshop me temë “Studentët dhe tregu i punës”, evidenca I.12].</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, i angazhuar në realizimin e programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, rezulton se, si personeli akademik me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kohë të pjeshme, i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie personel të kualifikuar me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar.</p> <p>Në programin “Bachelor në Gjuhë Turke” janë të angazhuar tre personel akademik me gradën shkencore “Profesor i Asociuar”, dy doktor shkencash dhe 2 me gradën Dr., pra 5 lektorë PAE, të cilët mbulojnë ngarkesën e orëve në masën 70 %, sipas udhëzimeve përkatëse të ligjit, si dhe gjithashtu janë të angazhuar 5 lektorë PAK me master shkencor/</p> <p>[Ref: Grupet mësimore të Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, evidenca I.18].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në programin “Bachelor në Gjuhë Turke” janë të angazhuar tre personel akademik me gradën shkencore “Profesor i Asociuar”, dy doktor shkencash dhe 2 me gradën Dr., pra 5 lektorë PAE, të cilët mbulojnë ngarkesën e orëve në masën 70 %, sipas udhëzimeve përkatëse të ligjit, si dhe gjithashtu janë të angazhuar 5 lektorë PAK me master shkencor/</p> <p>[Ref: Grupet mësimore të Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, evidenca I.18].</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se, bazuar në shqyrtimin e CV-ve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, diploma, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike, përvoja e niveli i kualifikimit, veprimtaria shkencore, si dhe botuese e mëparshme dhe përgjatë zhvillimit të programit, janë në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Përveç personelit të kualifikuar me kohë të plotë, departamenti ka aktivizuar për programin dhe lektorë me kohë të pjeshme dhe lektorë të departamenteve të tjera.</p> <p>[Ref: Ndarja e ngarkesës mësimore për 2019-2020, evidenca nr. 3].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në</p>	<p>Nga takimet me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik e studentët e regjistruar në programin Bachelor në Gjuhë Turke, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se për orientimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale, punimit të diplomës etj., është caktuar një staf i duhur akademik, me kualifikimin përkatës. Specifikisht Departamenti në bashkëpunim me njësinë kërkimore shkencore të fakultetit,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>promovon kërkime e studime krahasuese të pedagogëve dhe studentëve në fushat tyre. Bazuar dhe në RVB dhe intervistat e zhvilluara, Departamenti është angazhuar në rrjetin e bashkëpunimit akademik e kërkimor me pedagogë e studentë të Institucioneve Arsimore të Larta homologe. Kjo është konkretizuar me organizimin e konferencave, seminareve e tryezave të përbashkëta, duke synuar forcimin dhe zgjerimin dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe të rejtat shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p>Programi Bachelor nuk ofron praktika profesionale.</p> <p><i>GVJ sugjeron përfshirjen e praktikave profesionale edhe në programin Bachelor, krahas atij në Master.</i></p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të studimit "Bachelor në gjuhë turke", evidenca I.4, Studentët e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike].</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin përkatës, si dhe nga vizita e GVJ në mjediset e institucionit, rezulton se në shërbim të veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, si dhe në mbështetje të realizimit të programit "Bachelor" në "Gjuhë Turke", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka një infrastrukturë efektive në shërbim të mbarëvajtjes së programeve që ofrohen. Kështu për mbarëvajtjen e mësimdhënies në këtë program, përdoret Laboratori Fonetik i Gjuhëve të Huaja, i cili mundëson formimin praktik të studentëve. Për mirëmbajtjen e laboratorit dhe mjediseve të tjera mësimore, FGJH ka angazhuar personel ndihmës akademik, laborant, me formim në gjuhë të huaj.</p> <p><i>[Ref: Aneksi I. Tabela 2.1 dhe tabela 2.2, evidenca nr. 3].</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1


Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e institucionit, të njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë, që ofron programin në shqyrtim, GVJ konstaton se, që në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, Planit Strategjik të Zhvillimit të Fakultetit, Strategjisë së Zhvillimit të Departamentit, Strategjisë së Zhvillimit të Programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke” dhe Politikave të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, përcaktohen si prioritet strategjik zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, si një element i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe përmirësimit të cilësisë së ofertës akademike në çdo program studimi, që zhvillohet në njësitë bazë të UT.</p> <p>Universiteti i Tiranës ofron vazhdimisht trajnime, të cilat ofrohen nga qendra virtuale e zhvillimit profesional dhe trajnimit: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnim-it-dhe-zhvillimit-profesional/</p> <p><i>[Ref: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023; Rregullorja e Programit të studimit; Rregullorja e Brendshme e UT “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19”, e ndryshuar, evidenca nr. 47].</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se në institucion dhe në njësitë përgjegjëse, funksionojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të procesit mësimor e performancës së personalit akademik dhe ndihmës akademik. Përcaktuar me statut e sipas Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, në rang institucioni funksionon NJSBC për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, e cila si formë të veprimtarisë së saj ka vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, organizimin e pyetësorëve me studentët për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë të programeve të studimit dhe efikasitetin e programeve të ofruara. NJSBC evidenton përmbushjen e detyrave me hartimin e raporteve të vlerësimeve për çdo program studimi, të cilat shërbejnë si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe për vlerësimin e jashtëm.</p> <p><i>[Ref: Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2018-2023, evidenca nr. 4; Strategjia e UT 2018-2023, evidenca nr. 4.1; Strategjia e FGJH, evidenca nr. 4.2; Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e NJSBC, evidenca nr. 48; Manual i sigurimit të cilësisë, evidenca nr. 9.3; Paketa e Instrumenteve të cilësisë, evidenca nr. 9.4; VKM Nr. 531 datë 11/09/2018 Kodi i Cilësisë, evidenca nr. 9.5; Përcillet vendimi i Rektoratit Nr. 08, datë 29.03.2022), evidenca nr. 9.6; Rregullore për funksionimin e njësisë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, evidenca nr. 48; Urdhër/vendim për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së në nivel njësie kryesore, evidenca nr. 9.8; Urdhri i dekanit për ngritjen e GVB-së, evidenca nr. 1].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajnimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe intervistat e zhvilluara me drejtues, staf akademik dhe studentë të programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, NJSBC përfshin studentët në vlerësimin periodik në mënyrë anonime nëpërmjet një pyetësori, i cili realizohet çdo</p>

	<p>semestër dhe në përfundim të mbledhjes së të dhënave bëhet përpunimi i tyre dhe diskutimi i rezultateve.</p> <p>Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen dhe rezultatet i bëhen me dije stafit akademik. Nëpërmjet kësaj metode merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit, pedagogët e angazhuar, cilësinë e mësimdhënies dhe materialit të ofruar në syllabus, literatura, vlerësimi i dijeve, etj.</p> <p>Në lidhje me ankesat për provimet, ato i paraqiten me shkrim përgjegjësit të departamentit. Nëse verifikohet gabimi, përgjegjësi i departamentit në bashkëveprim me komisionin e provimit bëjnë korigjimin. Në rast të pamundësisë së zgjidhjes së ankesës, vihet në dijeni dekani, i cili brenda ngre një komision ad-hoc, që bën verifikimin e pretendimeve të studentit.</p> <p><i>[Ref: Pyetësori i studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, evidenca nr. 37].</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit përkatës, RVB dhe nga biseda me përfaqësues të NJSBC, drejtuesve dhe stafit akademike, konfirmohet se është në praktikën e punës së institucionit, njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë, që rezultatet e procesit të vlerësimit, pasi përpunohen nga struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, u komunikohen autoriteteve drejtuese të institucionit, posaçërisht përgjegjësit të departamentit, i cili ia bën të ditur personelit akademik.</p> <p>NJSBC informon përgjegjësën e departamentit/dekanin rreth rezultateve të dala nga pyetësorët me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen. Në përfundim të këtij procesi, hartohet një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të programit të studimit, përkundrejt standardeve të cilësisë. Studentët marrin pjesë gjithashtu në Sondazhin Kombëtar të Studentëve, i cili zhvillohet nga ASCAL.</p> <p><i>[Ref: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, evidenca nr. 35; Raporti vjetor 2019-20, evidenca nr. 35.1; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021, 1 FGJH, evidenca nr. 35.2; Raporti vjetor 2018-2019 Sllave dhe Ballkanike, evidenca 35.3; Aktivitete- Konferenca- ëorkshop, evidenca 35.4; Raporti i veprimtarisë mësimore kërkimore-shkencore për vitin 2020-2021, evidenca 35.5].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në takimet në institucion, si dhe nga dokumentacioni, GVJ vëren se, ndërsa është krijuar një proces institucional vlerësimi për performancën e stafit akademik, kjo nga ana tjetër konsiderohet si procedurë, që ndihmon për të kuptuar edhe shkallën e nevojave dhe përmirësimeve në këtë proces. Drejtuesi u komunikon anëtarëve të stafit, në rrugë personale, të dhënat nga vlerësimi i performancës së tyre në mësimdhënie, mbështetur tek pyetësorët e kryer. Bazuar në procesin e vlerësimit, departamenti promovon shembuj të praktikave të mira, nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, si dhe harton konkluzione dhe rekomandime, të cilat përkthehen në plan masash për të inkurajuar dhe zhvilluar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së pedagogëve.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, evidenca nr. 35;]</i></p>

	Raporti vjetor 2019-20, evidenca nr. 35.1; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021 FGJH, evidenca nr. 35.2; Raporti vjetor 2018-2019 Sllave dhe Ballkanike, evidenca nr. 35.3; Aktivitete-Konferenca- ëorkshop, evidenca nr. 35.4; Raporti i veprimtarisë mësimore kërkimore-shkencore për vitin 2020-2021, evidenca nr. 35.5; Rregullore e NJSBC, evidenca nr. 39; Manual i sigurimit të cilësisë, evidenca nr. 15; Paketa e Instrumenteve të cilësisë, evidenca nr. 20; Urdhri i dekanit për ngritjen e GVB-së, evidenca nr. 1].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve, rezulton se institucioni e ka ndërtuar procedurën e format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të dijeve, në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi (VKM Nr.531, datë 24.01.2018). Procesi mësimor është i organizuar me leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktika profesionale, teste, provime semestrale dhe mbrojtje e diplomës/provim i përgjithshëm përfundimtar, si dhe ëorkshop-e, seminare dhe konferenca shkencore. [Ref: Planet mësimore 2018- 2019, 2019-2020, 2020-2021, evidenca nr. 19.1; Syllabusët e lëndëve të ofruara në vite, evidenca nr. 66-174; Rregullore e Programit të Studimit, evidenca nr. 8; Aneks RVB: Tabela 13].
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Bazuar në bisedën me përgjegjësën e njësisë bazë, stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe studentë të programit, evidentohet se personeli bën përpjekje t'u përgjigjet nevojave dhe diversitetit të studentëve, si dhe sugjerimeve të tyre lidhur me programin e mësimdhënien. Studentët e programit "Bachelor" në "Gjuhë Turke" vijnë nga mjedise shoqërore e kulturore të ndryshme me pritshmëri të larta, ndaj stafi mësimor është përpjekur të realizojë në mënyrë profesionale, detyrimin dhe me forma, metoda, aktivitete formuese e mundësi alternative mësimdhënieje t'u përgjigjet interesave e këndvështrimeve, si dhe aspiratave të auditorit. Personeli akademik për të rritur cilësinë e mësimdhënies, nxit gjithashtu studentin për të qenë pjesë aktive e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive, të cilat shoqërohen nga një përdorim i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit, të cilat ndihmojnë në prezantime më cilësore. Gjatë kohës së pandemisë u shfrytëzuan dhe platforma të ndryshme dixhitale si: Webex Meeting, Microsoft Teams, Google Meeting, Zoom, Google Classroom etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>[Ref: Statuti i UT, evidenca nr. 19; Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, evidenca nr. 50; Manuali i përdorimit të Microsoft Teams, evidenca nr. 29].</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni realizon forma të ndryshme në mbështetje të personelit akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike e përdorimin e metodave të reja pedagogjike. Kështu zhvillohen herë pas here nga IAL trajnime të ndryshme, të cilët rrisin performancën akademike dhe didaktike të lektorëve, ku si rezultat i këtyre prezantojnë dhe përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe burimesh të mësimdhënies dhe të nxëniet, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët. Këto forma dhe metoda të mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. <i>[Ref: Statuti i UT, evidenca nr. 19; Rregullore e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore e Programit të Studimit, evidenca nr. 8].</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Nga biseda e GVJ me stafin akademik e studentë të programit, si edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe angazhimit të tyre përkatës në lëndët e programit të studimit, rezulton se titullarët e lëndëve kanë një background të pasur akademik dhe shkencor në fushat e tyre të studimit dhe mësimdhënies, eksperiencë profesionale në metodologjitë e didaktikën mësimore. Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie vlerëson profilet e studimit dhe të specializimit të personelit akademik, interesat e tyre mësimore-kërkimore për të realizuar në fillim të çdo viti akademik, si dhe planifikimin e shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik, që angazhohet në programin e studimit. Departamenti merr gjithashtu në konsideratë: a) përvojën mësimore dhe kërkimore shkencore në fushën përkatëse; b) publikimet shkencore të realizuara në fushën përkatëse; si dhe c) gradën shkencore/titullin akademik që mban secili lektor. <i>[Ref: Plani mësimor i këtij programi studimi, Tabela 2, 6, 7, 9 12; CV-të e stafit akademik, evidenca nr. 3].</i>
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga takimi i GVJ me përgjegjës të departamentit, stafin akademik dhe grupin e studentëve të programit, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton kujdesi e përpjekja nga ana e institucionit për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimet e sugjerimet e studentëve. Procesi i realizimit të vlerësimit të brendshëm, formë e të cilit janë edhe plotësimi i pyetësorëve nga ana e studentëve, ndihmon në analizën, reflektimin dhe përmirësimin nga ana e stafit pedagogjik të cilësisë së mësimdhënies, të didaktikës e metodologjisë së përdorur, literaturës, etj., të lidhur me programin.
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	

	<p>Nga biseda me stafin akademik dhe studentë të programit, evidentohet përpjekja e stafit akademik për të përdorur metoda interaktive dhe diskutimi, që i bëjnë interesante e efektive orët e mësimit.</p> <p>[Ref: Statuti i IAL, evidenca nr. 19; Strategjia e zhvillimit të institucionit (UT/FGJH), evidenca nr. 4; Strategjia e FGJH, evidenca nr. 4.2; Raporti Vjetor i departamentit dhe i NJSBC, viti akademik 2019-2021, evidenca nr. 36; Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Syllabuset e lëndëve, evidenca nr. 66-174; Rregullore e programit të studimit; Aneks RVB, tabela 14, evidenca nr. 8].</p>		
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga biseda me stafin pedagogjik dhe studentët e programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, rezulton se ekziston një marrëdhënie pedagog-student, një frymë pozitive e njerëzore komunikimi, si dhe bashkëpunimi në fushën e mësimdhënies. Studentët pohuan përpjekjen nga ana e stafit për të inkurajuar tek ata sensin e autonomisë, diskutimin e lirë, marrëdhënie bashkëpunimi dhe komunikim frytdhënës.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit, orët mësimore në auditor organizohen në orë leksioni dhe seminaresh. Orët e leksionit sikurse reflektohet edhe në planet lëndore janë orë mësimore të drejtuara nga pedagogu në funksion të orientimit të studentëve në kuptim dhe përvetësim të teorive dhe koncepteve lëndore. Bazuar dhe në RVB orët e seminareve inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit për të hulumtuar dhe studiuar literaturë të rekomanduar ose alternative në mënyrë të pavarur jashtë auditorit, në funksion të përgatitjes paraprake për diskutim përgjatë orëve të seminarit.</p> <p>Marrëdhëniet pedagog-studentë në departamentin e Gjuhëve Sllave e Ballanike dhe programin e studimit karakterizohen nga një atmosferë bashkëpunimi e mirëkuptimi në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies, në gjetjen e formave e rrugëve sa më efektive në edukimin e tyre. Personeli akademik vendos për studentët orare konsultimi dhe takimi jashtë orëve mësimore.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Planet mësimore 2018- 2019, 2019-2020-2020-2021, evidenca 19.1; Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite, evidenca 66-174; Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, evidenca nr. 35; Raporti vjetor 2018-2019, 2019-20, 2020-2021, FGJH, evidenca nr. 35.2; Raporti i veprimtarisë mësimore kërkimore-shkencore për vitin 2020-2021, evidenca nr. 35.5; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Aneks RVB - Format e mësimdhënies, tabela 14].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pastra e të mirëmbajtura për zhvillimin e procesit mësimor e shkencor. Bazuar në RVB dhe vëzhgimet në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, vihet re se ka patur dhe një rikonstruksion, gjë e cila i përgjigjet nevoja dhe standardeve të kvrkuara. Këto mjedise dallohen për nga ndriçimi i bollshëm natyror, sistemi i ftohjes dhe ngrohjes qendrore, që garanton kushte të favorshme për leksion.</p> <p>[Ref: Aneksi, Tabela nr. 16, evidenca 3].</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se mjediset që i dedikohen procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Ekziston një lidhje e qëndrueshme Ëifi, që shfrytëzohet brenda klasave gjatë mësimit dhe që ndihmon zhvillimin interaktiv dhe atë në distancë të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies, si dhe gjithashtu ambientet e mësimdhënies janë të pajisura me kompjuterë, video projektorë dhe monitorë, të cilat janë në shërbim të procesit mësimor për Programin e Studimit “Bachelor” në “Gjuhë Turke”. Studentët dhe pedagogët janë të pajisur gjithashtu me një adresë postare elektronike nga institucioni, e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Të gjitha zyrat e personelit akademik janë të pajisura gjithashtu me printerë, fotokopje dhe skanerë për të siguruar lehtësi në punën e personelit akademik në funksion të procesit mësimor.</p> <p>[Ref: Raporti Vjetor i Fakultetit 2019-2021, evidenca 35; Buxheti i miratuar i UT, https://unitir.edu.al/buxheti-plani-i-shpenzimeve-per-vitin-financiar-ne-vijim-dhe-vitet-e-kaluara/ Aneks RVB, Tabela 16, evidenca: nr. 3; Rregullorja e Brendshme e UT “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19”, e ndryshuar, evidenca nr. 51; “Rregullorja e posaçme e UT mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online, evidenca nr. 47].</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me stafin pedagogjik dhe studentët e programit, si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike dhe digjitale) për disiplinat në përmbajtje të programit të studimit, është e aksesueshme për studentët në turqisht, shqip dhe gjuhë të tjera, për të garantuar marrjen e dijeve dhe informacionit të nevojshëm. Si procedurë, tekstet mësimore me propozim të titullarëve të lëndëve, miratohen nga departamenti e u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik.</p> <p>Studentët kanë mundësi gjithashtu të aksesojnë në kompjuterët e bibliotekës tituj të ndryshëm librash në PDF.</p> <p>[Ref: Syllabuset e lëndëve, evidenca nr. 16; Raporti Vjetor i Fakultetit 2019-2021, evidenca nr. 66-174; Jstor, evidenca nr. 43; Libra te shtuar</p>

	<p>2019-2021, <i>evidenca 43.2; listë librash, evidenca nr. 43.3, Lista e titujve, evidenca nr. 43.4; biblioteka online e UT</i>]. https://unitir.edu.al/biblioteka/ https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekën e institucionit, biseda me personelin, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se ajo disponon një numër botimesh, klasike dhe të reja edhe të viteve të fundit, për fushat kryesore të programit dhe është në pasurim e sipër me tituj të rinj. Në bibliotekë gjenden rreth 900 tituj në fushën përkatëse të programit të studimit.</p> <p>Në bibliotekën e fakultetit, disponohet literatura bazë dhe ndihmëse, përkthime të ndryshme, fjalorë, CD-ROM, etj. Nëpërmjet aksesit në bibliotekën digjitale JSTOR ofrohen më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina. https://unitiredu.sharepoint.com/sites/BibliotekaOnline</p> <p>Aksesi në U-library https://ulibrary.rash.al/ në bashkëpunim me Rrjetin akademik Shqiptar dhe Universitetit të Tiranës ofron nga databaset kryesore të paketave, ku gjenden mijëra revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin në fusha të ndryshme, ndër ta 6,600 periodikë dhe revista, mbi 6,000 periodikë peer-revieëed, mbi 4,000 periodikë të Web of Science or Scopus. [Lista e të dhënave të U-library nga Rash: https://ulibrary.rash.al/lista.pdf]. Biblioteka e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja garanton gjithashtu një numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p>[Ref: <i>Aneks RVB: tabela 17</i>] https://unitir.edu.al/biblioteka-online https://ulibrary.rash.al/</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se IAL ka në dispozicion të programit “Bachelor” në “Gjuhë Turke” bibliotekën dhe kompjuterë, të cilët shfrytëzohen nga studentët e programit për lëndët e programit për punimin e detyrave të kursit, temës së diplomës, apo studimeve specifike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës e biseda me personelin akademik e studentët, konstatohet se në funksion të mësimdhënies, shfrytëzohet efektivisht platforma online (e-learning).</p> <p>Stafi dhe studentët kanë gjithashtu adresa elektronike, të cilat mundësojnë komunikimin midis tyre për çdo nevojë.</p> <p>[Ref: <i>e-Student Pedagog, evidenca nr. 44.1; Manual sistemi e-Student, evidenca nr. 6; Manual përdorimi Microsoft Teams, evidenca nr. 7; Microsoft office 365 për student, evidenca nr. 44.4; Microsoft office 365 Teams, evidenca nr. 44.5; Udhëzues bazik Mixrosoft Teams, evidenca nr. 44.6</i>].</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato</p>	<p>Nga biseda e GVJ me stafin akademik dhe studentë të programit, si dhe nga njohja në sekretarinë mësimore me tematikën e diplomave të studentëve, që kanë përfunduar programin, rezulton se procesi i përgatitjes</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>dhe mbrojtjes së diplomave zbaton rregulloret e institucionit që, për këtë qëllim, ka një dokumentacion të gjerë e të qartë. Udhëheqja e temave bëhet në përputhje me orientimin nga ana e personelit akademik dhe sipas interesit të studentëve, në përshtatje me profilin përkatës.</p> <p>Programi parashikon provim në formë eseje argumentuese, e cila hartohet me (+/- 10% 1250 fjalë).</p> <p>Bazuar në RVB dhe intervistat e zhvilluara, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike nxit studentët me rezultate të larta dhe aftësi në kërkim, që në përfundim të detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit të ciklit të parë, që të zgjedhin realizimin e një teme diplome. Mbështetur ne Rregulloren e programit të studimit “Bachelor” në “Gjuhë Turke” dhe Rregulloren për diplomat e ciklit të parë të studimeve “Bachelor “në “Gjuhë Turke”, personeli akademik dhe koordinatori i programit të studimit i orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, duke organizuar takime periodike me studentët, që plotësojnë kriterin për përzgjedhjen e temës së diplomës. Për çdo student, që zgjedh të bëjë temë diplome, departamenti cakton një pedagog udhëheqës, detyrat dhe të drejtat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren për diplomat e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Gjuhë Turke”.</p> <p>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore Diplomimi e Programeve studimore te Ciklit I-Bachelor, evidenca nr. 40].</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies ka ngritur disa struktura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila garanton cilësinë e aktiviteteve akademike, aktiviteteve kulturore dhe sociale të stafit akademik dhe studentëve, si dhe aktivitetet administrative; - Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimi i cilësisë; - Drejtoria e teknologjisë inovacionit dhe statistikave; - Drejtoria e kërkimit shkencor, projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë. <p>Referuar statutit të UT, organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik, i cili ngre komisionet e përhershme në nivel institucional. Krahas saj, organe të tjera akademike janë Asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme shkencore.</p>



	<p>Strukturat e ngritura nga ana e institucionit merren me koordinimin e veprimtarisë midis njësive kryesore dhe njësive bazë të programit të studimit sipas rregulloreve të tyre të brendshme.</p> <p><i>[Ref: Statuti i UT-së, evidenca nr. 19; Rregullore e NJSBC, evidenca nr. 48; Për miratimin e paketës së dokumenteve për sigurimin e cilësisë, evidenca nr. 22; Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL, evidenca nr. 48; Manual i sigurimit të cilësisë, evidenca nr. 15; Paketa e Instrumenteve të cilësisë, evidenca nr. 20; VKM Nr. 531 datë 11/09/2018 Kodi i Cilësisë, evidenca nr. 9.5; Përcillet vendimi i Rektoratit Nr. 08, datë 29.03.2022, evidenca nr. 9.6; Rregullore për funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, evidenca nr. 49; Urdhër/vendim për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së në nivel njësie kryesore, evidenca nr. 9.8; Urdhri i dekanit për ngritjen e GVB-së, evidenca nr. 9.9; Aneks RVB, Tabela nr. 24, Të dhëna për anëtarët].</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Referuar materialeve të depozituara si rregullorja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe ajo e Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si njësi kryesore mban përgjegjësi për rritjen dhe vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në të gjitha programet që ai ofron. Ndërkohë departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe ndjek proceset mësimore e kërkimore në bashkëveprim me stafin. Departamenti organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimi, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte, detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Baza për zhvillimin e procesit mësimor në UT janë rregulloret, Strategjitë e Mësimdhënies; Plani Strategjik i zhvillimit të departamentit, seminarët dhe trajnimet.</p> <p><i>[Ref: Rregullore për funksionimin e njësive të sigurimi, evidenca nr. 48; Manual i sigurimit të cilësisë, evidenca nr. 15; Paketa e Instrumenteve të cilësisë, evidenca nr. 20; VKM Nr. 531 datë 11/09/2018 Kodi i Cilësisë, evidenca nr. 9.5; Përcillet vendimi i Rektoratit Nr. 08, datë 29.03.2022, evidenca nr. 9.6; Rregullore për funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, evidenca nr. 48; Urdhër/vendim për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së në nivel njësie kryesore, evidenca nr. 9.8; Mendimi i dekanit për ngritjen e GVB-së, evidenca 1; Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, evidenca nr. 44; e-Student Pedagog, evidenca nr. 44.1; Manual sistemi e-Student, evidenca nr. 44.2; Hapat për të aktivizuar dhe përdorur Microsoft Teams, evidenca nr. 7; Microsoft Office 365 për student, evidenca nr. 44.4; Microsoft</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>office 365 Teams, evidenca nr. 44.5; Udhëzues bazik Mixrosoft Teams, evidenca nr. 44.6].</i>
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Referuar takimit në institucion me stafin si dhe dokumenteve të konsultuara, rezulton që UT akordon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca, si dhe botime të artikujve në revista shkencore. Institucioni gjithashtu mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet, mundësuar prej ERASMUS +, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ konstaton se botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science janë të pakta. Ekspertët rekomandojnë që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit.</i></p> <p><i>[Ref: Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë: Raporti vjetor 2019-20, evidenca nr. 35.1; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021 FGJH, evidenca nr. 35.2; Raporti vjetor 2018-2019, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, evidenca nr. 35.3; Aktivitete, Konferenca, ëorkshope, evidenca nr. 35.4; Aneks RVB, Tabelat 18-20; Revista shkencore "Revista FGJH" evidenca: nr. 43.4].</i></p>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Referuar takimit në institucion me drejtuesit e Fakultetit, Departamentit si dhe stafin, rezulton që IAL nxit stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca, ëorkshope, si dhe botime të artikujve në revista shkencore nëpërmjet mbulimit të shpenzimeve financiare. IAL ka zhvilluar gjithashtu trajnime dhe seminare të ndryshme për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tij në mësimdhënie, si dhe përdorimin apo implementimin e metodave të reja pedagogjike.</p> <p><i>[Ref: Rregullore për funksionimin e njësisë të sigurimi, evidenca nr. 48; Për miratimin e paketës së dokumenteve për sigurimin e cilësisë, evidenca nr. 22; Manual i sigurimit të cilësisë, evidenca nr. 9.3; Paketa e instrumenteve të cilësisë, evidenca nr. 20; VKM Nr. 531 date 11.09.2018 KODI I CILESISE, evidenca nr. 9.5; Vendimi i Rektoratit nr. 08, date 29.03.2022, evidenca nr. 9.6; Rregullore për funksionimin e njësisë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, evidenca nr. 48; Urdhër/vendim për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së në nivel njësie kryesore, evidenca nr. 9.8; Urdhri i dekanit për ngritjen e GVB-se, evidenca nr. 1; Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, evidenca nr. 44; e-Student Pedagog, evidenca nr. 44.1; Manual sistemi e-Student, evidenca nr. 44.2; Manual përdorimi Microsoft Teams; evidenca nr. 44.3; Microsoft office 365 për student, evidenca nr. 44.4; Microsoft office 365 Teams, evidenca nr. 44.5; Udhëzues bazik Mixrosoft Teams, evidenca nr. 44.6].</i></p>

<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara në institucion, si me drejtuesit, ashtu dhe me stafin, GVJ konkludon se personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Përgjegjësitë e stafit akademik janë gjithashtu të përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e Departamentit.</p> <p>Gjithashtu personeli akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, ku p.sh. gjatë periudhës së pandemisë janë përdorur platformat e ndryshme online.</p>		
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>[Ref: Statuti i UT-së, evidenca nr. 19; Rregullorja e përgjithshme e UT-së (nenet 27-29), evidenca nr. 47; Rregullorja e Programit të Studimit, evidenca nr. 8; Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, evidenca nr. 35; Raporti vjetor 2019-20, evidenca nr. 35.1; Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2020-2021 FGJH, evidenca nr. 35.2; Raporti vjetor 2018-2019, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, evidenca nr. 35.3; Aktivitete, Konferenca, ëorkshope, evidenca nr. 35.4; Raporti i veprimtarisë mësimore kërkimore-shkencore për vitin 2020-2021, evidenca nr. 35.5].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion se kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në Rregulloren e UT-së, (neni 45, 46, 48 dhe 49), gjithashtu në Rregulloren e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Rregulloren e Departamentit, Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe në programet mësimore të lëndëve të programit të studimit. Në këto dokumente përcaktohet si formë kryesore e vlerësimit provimi. Kontrolli i dijeve bëhet me shkrim. Kontrolli i vazhdueshëm përcaktohet nga lektorët në programet mësimore duke përfshirë forma të ndryshme, si pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare, detyra kursi, punë minikërkimore, teste me alternativa dhe provimi përfundimtar. Në rregulloret e përmendura përcaktohen përgjegjësit për hartimin dhe miratimin e tezave të provimit, kriteret e futjes në provim për studentët, afatet e provimeve, mënyra e zhvillimit të provimit, procedurat e verifikimit dhe të sekretimit të provimeve, sistemi i vlerësimit me pikë, njohja e studentëve me rezultatet e provimeve, e drejta e ankimit, etj.</p> <p>Gjatë takimit me GVJ, studentët u shprehën se ata njihen me kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, që në orët e para të</p>

	<p>leksioneve, kur marrin programin e lëndës dhe i shpjegohen nga lektori i lëndës.</p> <p>[Ref: Rregullore e Programit të studimit, evidenca nr. 8; Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Aneks RVB, Tabela 15].</p>								
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Gjithashtu i nje studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe në Rregulloren e Programit të Studimit është i përcaktuar qartë detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo lënde, apo moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga titullari i lëndës.</p> <p>[Ref: Syllabuset e lëndëve për programin e studimit “Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Turk”, evidenca nr. 66-174; Guida/udhërrëfyese, evidenca nr. 49; Rregullorja e karrierës, evidenca nr. 13; Studimi i tregut të punës, evidenca nr. 17; Programi i transparencës, evidenca nr. 46].</p>								
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT-së dhe Rregulloren e FGJH-së, forma kryesore e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale dhe shkencore është provimi, i cili realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Në rregulloren e programit të studimit, specifikohet se përveç provimit vlerësimi mund të bëhet me detyra kursi, projekte, postera ose bazuar në një shumëllojshmëri formash të vlerësimit.</p> <p>Gjithashtu në programet mësimore të lëndëve lektorët përdorin forma të ndryshme të vlerësimit bazuar në specifikat e lëndëve që zhvillojnë, si vlerësimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes së studentit, punët minikërkimore, testet me alternativa etj.</p> <p>[Ref: Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Syllabusi i lëndës, evidenca nr. 66-174; Aneks RVB: Tabela 15].</p>								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Studimeve të UT-së, Rregulloren e FGJH-së, Rregulloren e Programit të Studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive, që ka përvetësuar studentit gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit gjatë gjithë semestrit si aktivizim në mësim, si testimi i gjatë vitit/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Sipas GVB, shkalla e përvetësimit të dijeve/vlerësimi bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 pikë (në përqindje nga 0-100%) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë), si dhe shprehet me shkronja nga F në A. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gjerat nga E në A janë kaluese.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar të dhënave të deklaruara nga grupi i RVB, për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur subjektivitetin, IAL përdor dhe sistemin dixhital. Gjatë periudhës së mësimit online universiteti ka përdorur platformën elektronike M. Teams.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, nga të cilët njëri është i brendshëm. Në Rregulloren e Programit të Studimit diferencohen komisioni i vlerësimit (kur ka dy ose më shumë pedagogë të lëndës) dhe komisioni i provimit (titullari i lëndës dhe një pedagogë tjetër).</p> <p>Komisionet ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; "Rregullorja e posaçme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online", evidenca nr. 52; Rregullore e Përgjithshme e UT-së, (neni 27 dhe 48), evidenca nr. 6; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT-së, neni 48, provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Në Rregulloren e FGJH-së, është e përcaktuar edhe mënyra e sekretimit, duke e mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Zhvillimi i provimeve në auditor monitorohet/mbikqyret nga pedagogu/pedagogët e lëndës. Pas përfundimit të korigjimit dhe vendosjes së notës, bëhet bashkimi i kodit me emrin e studentit. Rezultatet shpallen në vende të dukshme me kodin e studentit ose njoftimi u përcillet studentëve përmes sekretarisë online. Në periudhën e pandemisë është aplikuar testimi online.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; "Rregullorja e posaçme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online", evidenca nr. 52].</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Gjuhë Turke", garantohet komunikimi i vlerësimit të studentit jo vetëm përmes sistemit informatik, por edhe përmes takimit me studentët. Gjithashtu përcaktohet qartë e drejta e studentit për t'u konsultuar me pedagogun e lëndës mbi arsyet që e kanë çuar në atë vlerësim.</p> <p>Ndarja e vlerësimit në disa elementë si angazhimi në seminare, detyrat e kursit, minitestet bën që komunikimi midis pedagogëve dhe studentëve të jetë i vazhdueshëm.</p>

	<p>Nga takimi i GVJ me studentët, konstatohet që ata njihen me vlerësimet nga ana e pedagogëve dhe sqarohen për këtë vlerësim, si dhe kanë të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve.</p> <p>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; "Rregullorja e posaçme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online, evidenca nr. 52].</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në Rregulloren e Departamentit, Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor", Rregulloren e Diplomimit, në Kodin e Etikës në UT dhe programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, janë të shprehura qartë kërkesat dhe kriteret për të respektuar të drejtat e autorit dhe për të realizuar punime origjinale në respekt të etikës së kërkimit, sikurse janë të specifikuar masat që ndërmerren në raste të shkeljes së tyre.</p> <p>Gjithashtu fakti që provimet realizohen nga komisione të përbëra nga të paktën dy pedagogë, rrit mundësinë për të shmangur kopjimin.</p> <p>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; "Rregullorja e posaçme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online", evidenca nr. 52].</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë procesit të kontrollit stafi akademik shënon pikët për çdo ushtrim, si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, tezat miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Rezultatet e provimit hidhen në procesverbalin e detyrimeve.</p> <p>Në Rregulloret e UT-së dhe të FGJH-së shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet në sistemin me notë. Për të përcaktuar notën përdoret sistemi i vlerësimit me pikë të cilat kthehen në notë. Në rregullore është e përcaktuar qartë që rezultatet duhet t'iu bëhen të njohura studentëve në përfundim të provimit me gojë dhe brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit me shkrim. Pas korrigjimit të provimeve, procesverbalet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve nga data e afishimit të rezultateve përfundimtare.</p> <p>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT, (neni 49), evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; "Rregullorja e posaçme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online", evidenca nr. 52; Rregullore e sekretarisë mësimore, evidenca nr. 10].</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit, GVJ konstaton se institucioni garanton të drejtën e studentit për t'u ballafaquar me vlerësimin e fituar nga realizimi i detyrimeve që i bëhen të qarta nga pedagogu që në orën e parë të leksionit dhe janë të vendosura edhe në syllabusin e lëndës. Studentit i njihet e drejta për t'u ankuar për rezultatin përfundimtar të provimit.</p> <p>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT, (neni 49), evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion GVJ konstaton se studentëve i jepet e drejta që çdo kërkesë apo ankesë ta paraqesë me shkrim tek</p>


komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit. Përgjegjësi i Departamentit bën verifikimet dhe vë në dijeni dekanin. Dekani brenda 48 orësh duhet të ngre komisionin ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanin, komisioni përcakton vlerësimin. Procedura e ankimit protokollohet dhe arkivohet dhe rezultati final paraqitet në regjistrin e notave. [Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT, (neni 49), evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; "Rregullorja e posaçme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online", evidenca nr. 52].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thëllon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në fushën e programit të studimit. Kurrikula e programit i mundëson studentëve një formim të plotë për fushën e studimit dhe iu jep mundësinë të ndjekin studimet e ardhshme në specializime të fushës, qoftë në mësimdhënie por edhe specializime që i mundësojnë punësimin në institucione private dhe publike. [Ref: Rregullore e programit të studimit, neni 3, evidenca nr. 8].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje dhe në zbatimin të VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblylëse. Program i studimit përmban lëndë bazë, ndërdisiplinore dhe plotësuese të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën humane e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit, në fushën e gjuhësisë dhe përkthimit, etj. [Ref: Rregullore e FGJH, evidenca nr. 6; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Plani mësimor i programit të studimit, evidenca nr. 3].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Programi i studimit, bazuar në kornizën konceptuale, ka si synim të pajisë studentët me disa kompetenca dhe aftësi të cilat përputhen në pjesën më të madhe me kompetencat dhe aftësitë që synojnë lëndë të ndryshme përmes syllabuseve.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë	Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dhe takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit "Bachelor" në "Gjuhë Turke", në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>përfundim të çdo lënde apo moduli personeli akademik diskuton me studentët çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. [Ref: Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Syllabuset e lëndëve të programit të studimit, evidenca nr. 64-174].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur grupi i GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhës Turke organizon aktivitete shkencore me një numër pjesëmarrësish të konsiderueshëm. Personeli akademik ka realizuar leksione të hapura dhe seminare me lektorë të huaj, leksione të hapura dhe forume diskutimi nga lektorë shqiptarë ose specialistë të ndryshëm, si dhe trajnime të ndryshme. [Ref: Raporti Vjetor i Fakultetit, viti akademik 2019-2021, evidenca nr. 35].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi, bazohen në kuadrin e përbashkët evropian të referencave për gjuhën, teorinë dhe paradigmat. Në programin Bachelor në “Gjuhë Turke”, lëndët “Përkthim” dhe “Fonetikë”, zhvillohen kryesisht në laboratorin përkatës, duke i dhënë mundësinë studentit të konkretizojë aftësitë e përfutuara dhe të simulojë situata të ngjashme profesionale, që do i shërbejnë pas përfundimit të programit të studimit. Por programi nuk ofron praktikë profesionale në këtë nivel të studimeve. Prandaj GVJ sugjeron futjen e praktikës profesionale në mënyrë që studentët të njihen dhe me tregun e punës. [Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Referuar RVB dhe programeve të lëndëve të programit të studimit, personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup. Në pjesën më të madhe të syllabuseve është e përcaktuar, që një pjesë e pikëve të vlerësimit fitohen nga studentët me anë të pjesëmarrjes dhe diskutimit në leksione dhe seminare për tema të ndryshme, realizimit të detyrave në grup, realizimit të minikërkimeve shkencore në grup etj. Këto motivojnë dhe nxisin studentët për të shprehur pikëpamjet e tyre. [Ref: Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Syllabuset e lëndëve të programit të studimit, evidenca nr. 66-174].</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, duke e bazuar vlerësimin e studentit jo vetëm përmes provimit, por edhe përmes formave të tjera të kontrollit të dijeve, si pjesëmarrje në diskutime mbi çështje aktuale, përgatitje e detyrave të kursit në grup ose individuale, etj. Këto forma të stimulimit të studentëve për të vënë në zbatim njohuritë e fituara në lëndë/modulet e zhvilluara, e bëjnë leksionin më të tërheqës dhe nxisin studentin të zhvillojë mendimin kritik dhe ide novative për zgjidhje të problemeve të ndryshme sociale. [Ref: Statuti i UT-së, neni 120, neni 136, evidenca nr. 19; Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të</p>

	<i>studimit, evidenca nr. 8; Raporti Vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020, evidenca nr. 35; Aktivitete te Departamentit te Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, evidenca nr. 41].</i>		
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	IAL ofron mbështetje akademike për studentët, duke i ndihmuar ata për zhvillimin e karrierës dhe mbështetje për procedurat e mobilitetit të tyre. Referuar RVB, Universiteti i Tiranës i akordon një fond vjetor Këshillit Studentor, si mbështetje për aktivitetet dhe implementimin e ideve novatore, por nuk ka asnjë të dhënë mbi këtë fond dhe numrin e studentëve që kanë përfituar nga ai. [Ref: Statuti i UT-së, neni 120, neni 136, evidenca nr. 19; Rregullore e Përgjithshme e UT-së, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit Cikli i Parë në Gjuhë Turke, profile “Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Turk”, evidenca nr. 8; Raporti Vjetor i Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, viti akademik 2018-2019, 2019- 2020, 2021-2022, evidenca nr. 35].		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e disponuar institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Departamenti gjithashtu organizon leksione të hapura, seminare dhe aktivitete të ndryshme me pedagogë, specialist dhe ekspertë të institucioneve bashkëpunuese. Departamenti ka edhe raste të mobilitetit të studentëve përmes projekteve europiane të shkëmbimit Erasmus në Turqi. [Ref: Marrëveshje bashkëpunimi Erasmus+, evidenca nr. 35; Aneks RVB, Tabela 5].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Grupi i GVJ mbështetur në dokumentacionin e paraqitur konstaton se institucioni ka procedura të veçanta për provimin final ose temën e diplomës, e cila mbrohet para komisionit të posaçëm, që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim. Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës janë të përcaktuara në Rregulloren për Diplomat e Ciklit të Parë “Bachelor” në “Gjuhë Turke”, ku specifikohet se kush ka të drejtë të realizojë një punim diplome, si zgjidhet, përcaktohet e miratohet tema e diplomës, zgjedhja e udhëheqësit, të drejta dhe detyrimet, si ngrihet komisioni i vlerësimit, struktura e punimit dhe kriteret mbi etikën e studimit. Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi. [Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT-së (nenet 59-60), evidenca nr. 47; Rregullore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, 2003, 2010, evidenca nr.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	7.3, 7.4; <i>Rregullore e diplomimit për programin e studimit Cikli i Parë në Gjuhë Turke, profili "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Turk", evidenca nr.11].</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	<p>Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, përcakton procedurat, që duhet të ndiqen për informimin e studentëve dhe zhvillon orë të këshillimi për t'i orientuar studentët në lidhje me rregullat, udhëzimet për realizimin e punimit të diplomës.</p> <p>Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë, për fitimin e diplomës parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur, sipas specifikave të njësisë kryesore dhe të përcaktuar në rregulloren e brendshme të programit.</p> <p>Kriteret për fitimin e diplomës dhe diplomimin janë përcaktuar në rregulloren e UT-së, rregulloren e fakultetit dhe në rregulloret e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Përgjithshme e UT-së (nenet 59-60), evidenca nr. 47; Rregullore e Fakultetit Gjuhëve të Huaja, evidenca nr. 7.3, 7.4; Rregullore e diplomimit të programit të studimit Cikli i Parë Bachelor në Gjuhë Turke, profili "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Turk", evidenca nr. 11].</i></p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Referuar RVB, departamenti harton dhe miraton programin e provimit të formimit të cilit e përcjell për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore. Programi i referohet lëndëve të zhvilluara përgjatë 3 viteve të studimeve. Komisioni i hartimit të tezës kujdeset që të jetë gjithëpërfshirës në tezën që harton me pyetje nga program i studimit të shpërndarë tek studentët. Studentëve iu dërgohen gjithashtu programet përkatëse të hartuara nga pedagogët e lëndëve sipas fushave përkatëse për secilin profil studimi në fillim të semestrit të dytë, si dhe iu dërgohen gjithashtu modele të eseve të viteve të mëparshme, apo udhëzime ad-hoc për hartimin e eseve në varësi të specifikave të programit të studimit të njësisë bazë.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</i></p>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	<p>Bazuar në RVB, Departamenti ka në dispozicion të studentëve një rregullore për diplomat e ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Gjuhë Turke", në këtë rregullore janë të përcaktuara kriteret, të drejta dhe përgjegjësi të udhëheqësit, struktura e temës dhe të tjera elementë të nevojshëm për të ndihmuar studentët në përpilimin e temës së diplomës.</p> <p>Studentët zgjedhin temat mbi bazën e kërkesave, që ata paraqesin dhe atyre të propozuara nga stafi akademik i programit. Secili prej tyre ka një pedagog, i cili ka dhënë dhe miratimin e tij dhe është miratuar nga departamenti.</p> <p>Pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin, duke zhvilluar seanca orientuese përmes orëve të këshillimit.</p> <p>Udhëheqësi i temës asiston, kontroll dhe vlerëson punimin e studentit duke u siguruar, që shkrimi i temës është hartuar në përputhje me rregullat për stilin dhe paraqitjen, të publikuara në shtojcën nr. 1 të</p>

	<p>rregullore përkatëse: “Rregullore e diplomimit të programeve studimore të ciklit I - Bachelor”, miratuar me vendimin e Dekanatit Nr. 32 datë 18.03.2022.</p> <p>https://fgjh.edu.al/rregullore-diplomimi-e-programeve-studimore-te-ciklit-i-bachelor/</p> <p>[Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar RVB pedagogët ndihmojnë studentët me kryerjen e matjeve, analizave në terren apo të dhënave të grumbulluara në forma kërkimore. Studentët mund të përdorin ambientet e fakultetit për hedhjen e të dhënave tabelare, grafike dhe të analizës statistikore etj. Departamenti dhe personeli akademik asiston studentët në lehtësimin e kryerjes së matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucione apo jashtë tij sepse kjo është e përcaktuar në rregulloren e përgatitjes së diplomës.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 6; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren për Diplomat e Ciklit të Parë, udhëheqësi ka përgjegjësi të takojë studentin për konsultime, të japë mbështetje akademike në formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë, rekomandimin e literaturës, konsulencën për përgatitjen e punimit. Ai ka detyrimin të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës, të mbajë takime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit, të vlerësojë progresin dhe monitorojë standardin e punës së tij; të japë ose jo leje për mbrojtje.</p> <p>[Ref: Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të formimit ose mbrojtjes së diplomës studentit vlerësohet me pikë të cilat konvertohen në notë sipas një sistemi të detajuar. Për vlerësimin e punimit të diplomës, ngrihet nga përgjegjësi i departamentit një komision i cili përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, dhe miratohet nga dekani. Komisioni në fund të prezantimeve bën vlerësimin e tyre me notë. Gjithashtu në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret e vlerësimit.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur, me përfundimin e studimeve dhe fitimin e krediteve të nevojshme studentët, që kanë plotësuar kërkesat e planit mësimor dhe kanë dhënë provimin e formimit/temën e diplomës, pajisen me Diplomë Universitare “Bachelor” në “Gjuhë Turke” të shoqëruar me listën e notave, si dhe me suplementin e diplomës.</p> <p>[Ref: Statuti i UT-së, (neni 110, 111, 113), evidenca nr. 19; Rregullore e Përgjithshme e UT-së, (neni 63, 66), evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8; Model diplome dhe/ose Model Suplementi i Diplomës), evidenca nr. 52].</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT-së (Neni 111) dhe Rregulloren e Programit të Studimit, studentit pasi pajiset me Diplomë Universitare të miratuar nga</p>

dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Ministria e Arsimit ka në dispozicion një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, e cila është e detajuar edhe në suplementin e diplomës. [Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].		
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni bazuar në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, përcakton që sekretaria mësimore administrojnë, mirëmban e ruan regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave; procesverbalet e provimeve; dosjet me dokumentacionin e regjistrimit dhe të ç’regjistrimit të studentëve dhe dokumentacionin statistikor përkatës; arkivon dosjet e studentëve të diplomuar. Gjatë takimit të GVJ me sekretarinë u konstatua se institucioni ruan në mënyrë të rregullt regjistrat zyrtar të studentëve. Sekretarisë iu kërkua vënia në dispozicion e regjistrit të studentëve, e cila ishte plotësuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. [Ref: Rregullore e UT, evidenca nr. 47; Rregullore e programit të studimit, evidenca nr. 8].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe	UT mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit, duke përfshirë çdo anëtar të ri, në secilin semestër FGjH mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programet e studimit duke përfshirë të gjitha kategoritë; personel akademik, ndihmës akademik, administrativ. Seksioni i Gjuhës turke në organigramë ka 5 pedagogë të brendshëm dhe 5 të jashtëm.


atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	[Ref: Rregullore e brendshme e punës "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit UT" pdf. evidenca nr.4.9; Statuti i UT, neni 44, pika d, evidenca nr. 19; Të dhënat për stafin, evidenca nr. 4.19, Të dhënat tabelore për personelin akademik, evidencat nr. 20.21].		
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Gjatë vizitës në FGJH , GVJ realizoi një takim në Zyrën e burimeve njerëzore në të cilën u njoh me dosjet e stafit akademik dhe me kontratat e punësimit të tyre (Evidencat nr. 4.9, Lidhja 3. Pikat 1,2,3,21, Sektori i BNJ). Nga takimi rezultoi se FGJH zbaton procedurat e rekrutimit të stafit në përputhje me bazën ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Institucioni ruan dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kontratë në përputhje me legjislacionin (Evidencat nr 4.1, 4.4, 4.2. Statuti i UT, Rregullore e UT-së, Strategjia e zhvillimit institucional UT/FGJH)		
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Rekrutimin i personelit akademik, realizohet nëpërmjet procedurave specifike, në përputhje me bazën ligjore në fuqi, statutin dhe rregulloren e universitetit. Referuar takimit me përfaqësues të ZBNj, GVJ konstaton se institucioni bën publike kërkesën për vendin e punës, në përputhje me propozimet e ardhura nga Departamenti, Dekanati dhe miratuar nga titullari IAL. I gjithë procesi i vlerësimit të kandidatëve dhe rekrutimit të personelit akademik administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore pranë UT dhe FGJH (Evidenca nr 4.60- Procedurë rekrutimi stafi FGJH).		
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Vlerësimi dhe rekrutimit i kandidatëve bazohet në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit (Evidencat nr 4.1, 4.4, 4.2. Statuti i UT, Rregullore e UT-së, Strategjia e zhvillimit institucional UT/FGJH) (Evidencat nr. 4.9, Lidhja 3. Pikat 1,2,3,21, Sektori i BNJ). { Evidenca nr. 3.5. Rregullore e programit të studimit }. Procedura e rekrutimit realizohet nga DBNJ dhe bëhet publike në Bulletin e Njoftimeve Publike dhe në web. Kriteret për stafin që do të rekrutohet janë specifike për vendin vakant, ku theksi kryesor është vënë në kualifikimin në tituj/grada të kandidatit. GVJ konstaton se procedurat për rekrutimin e stafit të jashtëm përsëriten cdo vit akademik. Procedura është e qartë dhe transparente. <i>Gjithsesi, GVJ nuk konstatoi të kishte rekrutim të stafit të ri akademik me kohë të plotë në Seksionin e Gjuhës turke, Departamenti i Gjuhës Sllave-Ballkanike në 5 vitet e fundit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UT/FGJH ofron hapësira të mjaftueshme dhe kushte të mira mësimdhënies për stafin akademik . Gjatë vizitës GVJ u njoh me mjediset e punës, laboratorët, bibliotekën, sallat e leksioneve, seminareve dhe konstatoi se FGJH e ka prioritet krijimin e mjediseve dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit. Sallat e leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe bibliotekat janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike për realizimin e mësimdhënies me metoda e teknologji bashkëkohore edhe në përputhje me specifikat e lëndës. Aktiviteti mësimor zhvillohet në dy Godina {Godina A dhe B}, ku studentët zhvillojnë aktivitetin mësimor brenda një infrastrukture të nevojshme që kërkon mjedisi universitar. Në klasa ka 11 tabela interaktive, 2 kabina përkthimi, pajisje për konferenca e leksione online. Në dispozicion të këtj programi studimi janë salla me kapacitetin e mjaftueshëm për numrin e studentëve që ndjekin aktualisht programin e studimit.</p> <p>{Evidenca nr.4.36 “ Të dhënat për infrastrukturën në funksion të programit të studimit DGJSLLB. Tabela 16}.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni inkurajon stafin për kualifikim të vazhdueshëm dhe zhvillim të mëtejshëm profesional të personelit akademik që mbulon programi. {Evidenca nr.4.1, Statuti UT, neni 5}. {Evidenca nr. 4.58, Vendimi i Senatit Akademik nr. 28, datë 22.07.2021 " Për grantin për prezantim punimi ose kërkimi në konferencat ndërkombëtare}.</p> <p>FGJH mbështet stafin akademik për avancimin në kuafikim, si në pjesëmarrje në aktivitete shkencore e formuese brenda dhe jashtë vendit. FGJH realizon monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë formuese e profesionale nëpërmjet vlerësimit të brendshëm. {Evidenca nr. 4.31, Raportet vjetore te publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë}. {Evidenca 4.37, Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik për 5 vitet e fundit}.</p> <p>Pedagogët e Gjuhës turke kanë përfituar specializime të ndryshme në universitet europiane, kryesisht spanjolle. Stafi është aktiv në konferenca e kongrese shkencore ndërkombëtare. Kanë botime në revista të indeksuara ndërkombëtare dhe janë pjesëmarrës në borde shkencore ndërkombëtare të revistave dhe konferencave.</p> <p>Departamenti zhvillon edhe aktivitete të natyrës letrare e artistike të përvitshme. {Evidenca nr.4.37, Të dhënat tabelore të aktiviteteve të departamentit}. GVJ konstaton se në UT ka një qendër trajnimesh me qëllim trajnim e stafit për kërkimin shkencor.</p> <p>Aktivitetet zhvillohen me mbështetje të Ambasadës Turke, Institutit Junus Emre dhe universiteteve turke.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e</p>	<p>UT ka në synimin e tij mësimdhënie bashkëkohore në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe si rrjedhojë institucioni është aktiv në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>impementimin e ideve krijuese dhe nxitjen e mësimdhënies me anë të metodave bashkëkohore. Evidenca nr. 4, Mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme interaktive të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Evidenca nr. 4.777, Manuali I sistemit e-Studenti.</p> <p>GVJ konstaton se dy vitet e fundit, edhe si rrjedhojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, institucioni ka zhvilluar në nivel të ri sistemin informativ në shërbim të studentit dhe të teknologjive të reja që ndihmojnë kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik në aspekt mësimdhënës dhe kërkimor -shkencor. {Evidenca nr 3.77, “Mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies”}.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>FGJH dëshmon angazhimin e duhur për realizimin e objektivave të programeve të ciklit të parë të studimeve. Seksioni i Gjuhës Turke organizon shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe kontributet e tjera shkencore dhe institucionale të saftit me qëllim final përmbushjen e objektivave të programit të studimit. [Evidenca nr.4.32 Analiza vjetore e DGjS]. {Evidenca nr.4.17, CV e stafit akademik}.</p> <p>GVJ konstatoi se stafi akademik ka shfrytëzuar maksimalisht mundësitë për kualifikime, por ajo që bie në sy është se këto dominohen nga mobilitete ERASMUS, kryesisht për një kohëzgjatje vetëm disa ditore.</p> <p>Mbingarkesa në orë mësimi është për secilin nga anëtarët e stafit është 1.5 – 2 herë më e lartë se norma vjetore e ngarkesës mësimore. Ngarkesa e madhe në orë mësimi mund të ndikojë negativisht në performancën në mësimdhënie, apo angazhimin në kërkim shkencor.</p> <p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>FGJH/UT duhet të vlerësojë mundësinë e rekrutimit të stafit të ri akademik për të ulur ngarkesën në mësim të stafit ekzistues.</i> 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>FGJH/UT u siguron studentëve dhe stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>GVJ vizitoi ambientet dhe konstatoi se mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>FGJH disponon dy Godina A dhe B me infrastrukturë të përshtatshme dhe moderne për zhvillimin e procesit mësimor. Në ndihmë të studentëve të nivelit Bachelor procesi mësimor realizohet në fashën e orarit 8,00- 14.00.</p> <p>Evidenca nr 4.62 Orari mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset janë të pajisura me ajer të kondicionuar, ndriçim të vazhdueshëm, ëifi dhe mjete e nevojshme didaktike dhe teknologjike si; kompjuterë, videoprojektorë, tabela ineraktive, tavolina inteligjente të përfutuara kryesisht përmes projekteve të përfutuara nga stafi akademik i FGJH-së.11 auditorë janë të pajisur me 11 tabela interaktive të cilat mundësojnë realizimin një procesi mësimor bashkëkohor.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga informacionet që morëm nga stafi në dispozicion të programit mësimor është laborator i fonetikës dhe 2 laboratorë të përkthim-interpretimit. Në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve janë 3 pajisje për web-konferenca dhe pjesëmarrje online. Sallat e leksioneve janë të pajisura me kompjuterë inteligjentë. ST ka në përdorim 2 video-projektorë të cilët përdoren sipas orëve specifike, 3 laptopë, 5 kompjuterë, 2 fotokopje, skaner, printer të cilat janë aparatura dhe mjete të nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe kryesisht aftësimin teorik të objektivave formuese të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Evidenca nr.4.80 Inventari i departamentit të DGJSLLB Evidenca 4.35, Raporti vjetor i fakultetit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>FGJH disponon 6 laboratorë të shpërndarë në të dyja godinat e fakultetit të pajisura me mjetet teknologjike të përshtatshme për zhvillimin e orëve teorike dhe praktike kryesisht në lëndë të mësimin të gjuhës , fonetikës, përkthimit, bazuar në objektivat e programeve mësimore.</p> <p>Laboratori B 302 përdoret edhe për zhvillimin e lëndëve të informatikës. Laboratorët plotësojnë kushtet bashkëkohore për studentët e vitit të parë dhe të dytë.</p> <p>Evidenca Aneks RVB Tabela përmbledhëse nr. 16. Evidenca nr.4.16, Silabuset e lëndëve të ofruara ndër vite.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Programi nuk parashikon organizimin e praktikave profesionale në planin kurrikular, apo në planet mësimore lëndore, por pedagogët e lëndëve kanë parashikuar në silabuse, që lëndët të kenë orientim teorik e praktik.</p>

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Do të ishte me interes bashkëpunimi me institucionet e tjera, duke patur parasysh edhe vazhdimësinë në programin e ciklit të dytë dhe do të ndihmonte për të identifikuar programin e duhur e duhur për zhvillimin institucional. <i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon: Të shikohet mundësia e realizimit të orëve të praktikave mësimore në terren së paku në vitin e dytë të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Për programin e studimit UT ka një bibliotekë qendrore që është në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve të të gjithë programeve të tij të studimit. Ambientet e bibliotekës qendrore janë të bollshme, të mirë ndriçuar dhe mirëpajisura. Një pjesë e mirë e informacionit të fondit të tij është e dixhitalizuar dhe lehtësisht e aksesueshme. Nga ana e tij, FGJH ka krijuar bibliotekën e vet, në dobi të studentëve të programeve të tij të studimit, si dhe 2 biblioteka Argjiro dhe Rozafa në katin e dytë të Godinës A të FGJH-së. Në biblioteka ka specialistë përkatës.</p> <p>Të drejtën për të qenë anëtar i bibliotekës e kanë studentët, personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ si dhe komuniteti, të cilët janë të pajisur me kartela personale. Bibliotekat gjatë ditëve të javës është e hapur dhe në dispozicion të lexuesve në orarin 8:00-16:00. Bibliotekat shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programeve të studimit dhe pedagogët kanë akses pa pagesë në disa gjuhë të huaja dhe shqip në dy biblioteka virtuale online. Numri i kopjeve në total është 20297.</p> <p>Evidenca nr.4.39, <i>Lista e teksteve /periodikë në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.</i></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	<p>Biblioteka e FGJH-së ka faqen e saj zyrtare në gjuhën shqipe që ofron informacion për rregulloren, listën e titujve në dispozicion dhe informacion për Bibliotekat virtuale. Literatura në dispozicion është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e moduleve dhe veprimtarive shkencore tipike të programit.</p> <p>Vitet e fundit janë bërë përpjekje për të pasuruar fondin e bibliotekës së Fakultetit me literaturë në fusha të ndryshme të shkencave humane dhe sociale. Tekstet në fjalë janë në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Gjuhë-letërsi, turke”, pa pagesë.</p> <p>Evidenca 4.39, <i>Lista e titujve dhe biblioteka online.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Aksesi për të gjithë studentët në bibliotekat online është pa pagesë, një shërbim i realizuar nga RASH me mbështetjen e MASR. UT në bashkëpunim me Fondin Amerikan të Zhvillimit ka finalizuar marrëveshjen për abonim në bibliotekën digjitale JSTORE në funksion të procesit akademik. Studentët dhe pedagogët kanë akses në U-Librari, COBBIS+ që u mundëson kërkuesve shkencorë, pedagogëve e studentëve informacion dhe materiale që gjenden në bibliotekat e Shqipërisë. Në rregulloren e bibliotekave është shprehur qartë se shërbimi ofrohet pa asnjë dallim në mënyrë të barabartë. Evidenca nr. 4.39 Lista e titujve dhe biblioteka online. Evidenca nr. 4.55 Rregullorja e bibliotekës së FGjH-së.</p>						
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Bibliotekat janë të pajisura me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin e pa kufizuar nga ana e të gjithë studentëve. Ato shërbejnë edhe internet falas, janë të pajisura me kompjuterë, skaner, printer, video-projektor, laptop, ndriçim të mjaftueshëm. Evidenca nr. 4.55 Rregullorja e bibliotekës së FGjH-së.</p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni në mënyrë të përvitshme kërkon dhe harton buxhetin vjetor duke përfshirë në të edhe kërkesat e departamenteve dhe përgjegjësve të bibliotekave për pasurim me zëra të rinj dhe përditësim të fondit ekzistues në mbështetje të programit. Kushtohet vëmendje që materialet të jenë të rëndësishme dhe të përfshijnë tipe të ndryshme propozimesh. Evidenca nr.4.55 Rregullorja e bibliotekës së FGjH-së, neni 14, 13,11.</p>						
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka vendosin në dispozicion të studentëve orare shërbimi në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj, duke respektuar të gjitha fakultetet. Bibliotekat janë të hapura në fashat e orareve 08.00-16.30. Janë të mbyllura në fundjavë dhe ditët e festive. Bibliotekat zotërojnë statistika për numrin e përdoruesve. Evidenca nr.4.55 Rregullorja e bibliotekës së FGjH-së, neni 25.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi</p>	<p>UT përdor sistemet e-studenti , platformat webex meeting, Office, Zoom TIMS, OUTLOOK, për administrimin e informacionit që lidhet me studentët. Sistemet ka rritur ndjeshëm cilësinë e shërbimit ndaj studentëve në çdo aspekt të procesit, nga regjistrimi, transferimi,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>transkriptet e notave, etj., deri në diplomim. Në sistem janë të integruara pagesat e tarifave të shkollimit dhe i shërbimeve të tjera. Marrëveshja përkatëse me rrjetin akademik shqiptar (RASH) mundëson funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e plotë të sistemit. Studentët dhe pedagogët kanë akses të personalizuar. Siguria e të dhënave, garantohet nga respektimi i dispozitave të ligjit 9887 për mbrojtjen e të dhënave personale).</p> <p>Informacioni në UT mbahet në regjistra të shkruar me dorë dhe në format elektronikë. Institucioni disponon një sistem manual zyrtar i cili qëndron në ruajtje të përhershme. Regjistrat e shkruar me dorë kanë përparësi, por për korrigjimet e mundshme në ata ka një rregullore të vecantë (<i>Shtojca 4.7-Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf, Neni 3</i>).</p> <p>Elementë të tjerë të rëndësishëm të dokumentimit të aktivitetit të studentëve dhe pedagogëve janë regjistrat e pedagogëve dhe formularët e ngarkesës mësimore (<i>Rregullore e UT, neni 42</i>). Këto dokumente administrohen nga vetë pedagogët, por periodikisht monitorohen dhe konfirmohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Evidenca nr.4.77. Sistemi e-studenti, Manual përdorimi 2022.</p> <p>U vizitua faqja e internetit (https://www.unitr.edu.al/), informacioni gjendet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, por informacioni në gjuhën angleze nuk është i plotë (shembull- programet mësimore).</p> <p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të FGJH-së në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj</i> <p><i>Përmirësimin e përmbytjes së informacionit në shërbim të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në drejtorinë e burimeve njerëzore rezulton se administrohet dhe përditësohet me përpikmëri i gjithë informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i të gjithë personelit të angazhuar, klasifikuar sipas kategorive përkatëse.</p> <p>Për të intensifikuar komunikimin midis stafit dhe komunikimet student pedagogë janë bërë përpjekje për instalimin e programit platformës software <i>e-student</i>, e cila lejon shërbime të nevojshme për çdo grup studentit, pedagogu në çdo kohë dhe në mënyrë transparente.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Moduli për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin e personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ ende nuk është pjesë e platformës <i>e-student</i>.</p> <p>GVJ konstaton se pavarësisht mospërfshirjes strukturat përgjegjëse për ruajtjen e informacionit ruajnë dhe vënë në dispozicion informacionin sipas kërkesave për shfrytëzimin e materialit.</p> <p>Evidenca nr. 4.9, Rregullore e brendshme e punës: Për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit UT”.</p> <p>Evidenca nr.4.77. Sistemi e-studenti, Manual përdorimi 2022.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Njësitë kryesore në UT kanë detyrim ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit.</p> <p>Në faqen zyrtare të FGJH-së pasqyrohen të dhëna të përditësuara për personelin akademik ,drejtuesit e njësisë kryesore, rregulloret, aktivitet shkencore dhe promovuese, veprimtaritë kërkimore -shkencore</p>

	<p>UT përdor sistemet e-studenti, platformat webex meeting, Office, Zoom Teams, Outlook, për administrimin e informacionit që lidhet me studentët të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Evidenca nr. 4.40. <i>Strategjia e teknologjisë dhe inovacionit në mësimdhënie e mësimnxënie.</i></p> <p>Në dispozicion të studentëve të STsë ka postë elektronike @unitir.edu.al me qëllim sigurimin e informacionit zyrtar në kohë reale për stafin dhe studentët.</p>						
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi e-studenti UT, lejon monitorimin në kohë reale të a aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët sistemi mundëson raporte statistikore, ecurinë akademike, pagesat e tarifave etj. Aktiviteti akademik dhe administrativ verifikohet nga njësia bazë, si njësi përgjegjëse e programit të studimit që ofron.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit mbikqyr mbarëvajtjen e procesit mësimor, prezencën e stafit.</p> <p>Procesi mësimor evidentohet nëpërmjet regjistrave mësimor si dokument shtetëror ku pasqyrohet realizimi i programit, mungesat, frekuentimi.</p> <p>Evidenca nr 4.4 <i>Rregullore e UT, neni 41,9,20,21,22,23.</i></p> <p>Evidenca nr 4.1 <i>Statuti i UT, neni 5, 14.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se nuk realizohen monitorime rutinë në terren për procesin mësimor si nga njësia bazë, ashtu edhe nga njësia qendrore.</i></p> <p><i>E vetmja formë monitorimi është regjistri i pedagogut, ndaj së cilit pedagogu ka përgjegjësinë për plotësimin dhe menaxhimin e tij.</i></p>						
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> <p>U vizitua faqja e internetit (https://www.unitir.edu.al/), informacioni gjendet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, por informacioni në gjuhën angleze nuk është i plotë (shembull- programet mësimore).</p> <p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UT në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj</i> • <i>Përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve</i> 						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1545 742 1624">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="742 1545 949 1624">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="949 1545 1157 1624">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1624 742 1668"></td> <td data-bbox="742 1624 949 1668"></td> <td data-bbox="949 1624 1157 1668" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.6
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se buxheti i universitetit hartohet dhe miratohet duke filluar nga njësitë bazë, kryesore , sipas nevojave të tyre specifike dhe njësisive ndihmëse të tij: Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Financiare, të cilat kanë rregulloret e tyre të funksionimit. Autonomia financiare i lejon UT të hartojë raport financiar të kostove të programit të studimit dhe për mbështetje financiare te nevojshme. Tarifat e studimit janë miratuara me vendim SA dhe BA.</p> <p><i>Evidenca nr.4.1 Statuti i UT, neni 142,143,144,7.</i></p> <p>UT harton kosto mesatare studenti në nivel universiteti.</p> <p><i>Evidenca nr 4.43, Të dhëna nga raporti financiar i FGJH-së</i></p> <p><i>Evidenca nr 4.44, Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>UT ndjek procedurat e përcaktuara ligjore lidhur me hartimin e buxhetit (<i>Evidenca 4.1-Rregullorja, Statuti i ILAL</i>) dhe ka struktura përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe auditimin e tij.</p> <p>Buxheti i institucionit miratohet nga Senati akademik dhe Bordi i administrimit të IAL-s .Realizimi i tij monitorohet periodikisht, po ashtu nga Senati dhe Bordi i Administrimit të institucionit (<i>Evidenca 4.1-RregullorjaStatuti i ILAL, neni 62,65, 60, 55</i>)</p> <p>Shpërndarja e burimeve njerëzore realizohet në mbështetje të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij, sipas kërkesave të ardhura nga njësia bazë dhe njësia kryesore.</p> <p><i>Evidenca nr.4.44 Kërkesa buxhetore të FGJH-së.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4.43 Përcjellje e projekt-propozimit të buxhetit FGJH.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UT kryen auditim të përvitshëm, të brendshëm ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar institucionit.</p> <p>UT i nënshtrohet edhe auditit të jashtëm kryesisht prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MASR.</p> <p>Në organigramën e UT është Drejtoria e Audit të Brendshëm ,e cila është në varësi të BA. Kjo drejtori kryen kontroll periodik dhe paraqet pranë BA një raport të hollësishëm financiar për shpërndarjen e shpenzimeve.</p> <p><i>Evidenca nr.4.42 Të dhëna nga raporti financiar i FGJH-së</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4.43 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion "Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit" (i cili është programi buxhetor vjetor dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	afatmesëm, 2021 - 2023, në relacionin shoqëruar jepet informacion i detajuar mbi të ardhurat nga burime të ndryshme si nga pronësia, shërbimet administrative, shërbimet për të tretët, tarifat e studimeve në ciklet e ndryshme etj; kërkesat buxhetore për vitin 2021. Këtu përfshihen kërkesa si financimi i burimeve njerëzore, bursa etj.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	UT siguron burime financiare nga: Grantet e akorduara nga MASR. Fondet e vetë institucionit që sigurohen nga tarifat e shkollimit, projektet. Fakultet përcjellin pranë rektorati çdo vit kërkesat buxhetore të përditësuara në shërbim të programeve të studimit. Evidenca nr. 4.1, Statuti i UT, neni 145, 147. DGJSLLB/ST përfiton financime nga Ambasada turke për aktivitete kulturore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UT zhvillon politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. procedurat që mbulojnë ciklin e parë të studimit akademik nga hyrja në dalje janë të përcaktuara nga UT, nga SA dhe njësitë bazë në fakultete. Evidenca nr. 5.68 "Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat në hyrje synojnë të përzgjedhin kandidatë me rezultate sa më të larta. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga MASR. Në vazhdimësi të programit synohet që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike, duke u garantuar baraza dhe të drejta të barabarta deri në përfundim të studimeve të tyre. Evidenca nr. 5.4 "Rregullore e UT, neni 31".
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të	Kuotat dhe kriteret propozohen nga njësitë bazë dhe miratohen nga SA. Rregullorja e organizimit të programit të studimit përmban informacionet e nevojshme të kuptueshme për publikun. Të dhënat për kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve janë të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>aksesueshme në portalin U-Albania dhe në faqet online të UT dhe FGJH-së. GVJ verën se në këtë program studimi nuk ka transferime të studimeve. Kjo justifikohet me faktin se ky është një program unik dhe ofrohet vetëm nga UT/ FGJH.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Për programet e studimit UT/ FGJH harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve. Pranimi i tyre realizohet sipas udhëzime të përcaktuara nga MASR. Sipas Statuti të UT-së departamenti propozon kuotat dhe kriteret e veçanta, të cilat miratohen në SA, BA dhe MASR. Kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve, procedurat e përparimit të studentëve gjatë kursit të studimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të studimeve, njohjes së studimeve të mëparshme të plota apo të pjesshëm, pasqyrohen në nenet përkatëse të rregullores respektive. Evidenca 5.1, Statuti i UT-së, neni 90. Programi nuk përmban kritere të veçanta pranimi për studentët shqipfolës. Kriteret për pranimin e studentëve të huaj hartohen në përputhje me marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe përkatëse sipas kandidatit dhe bëhen publike në faqen e web-it të FGJH-së dhe portalin U-Albania.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me Ligjin e arsimit të Lartë VKM-në për përcaktimin e notës mesatare, Udhëzimet e përvitshme të MASR-së mbi procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë. Kriteret përcaktohen nga departamenti, përcillen nga dekani dhe miratohen nga SA. Kriteret për pranimin e studentëve të huaj hartohen në përputhje me marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe përkatëse sipas kandidatit dhe bëhen publike në faqen e web-it të FGJH-së dhe portalin U-Albania. Departamenti përcakton kuota pranimi për kandidatën nga trojet, shtetas të huaj, persona me aftësi të kufizuar, jetimë , romë. Kuotat përcaktohen duke pasur parasysh edhe kapacitet pritëse të FGJH-së. Evidenca nr 5.56, Vendime të dekanatit të FGJH-së mbi përcaktimin e kritereve të pranimit për vitet akademike 2018,2019,2020.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Publiku i interesuar njihet me kriteret e veçanta dhe të përgjithshme nëpërmjet faqes së webit të FGJH, së departamentit dhe me anë të rrjeteve sociale dhe multimedias. FGJH për këtë qëllim organizon pranë fakultetit aktivitete në kuadër të Open day ku jepen informacione për programet e studimit. Departamenti ruan lidhjet me Alumnin, ka në dispozicion të publikut broshura informuese për programin, institucionin, jetën studentore. <i>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ vërejtë se numri i studentëve në pesë vitet e fundit ka pësuar ulje. Nga bashkëbisedimi i GVJ-së me studentët e degës, stafin</i></p>

	akademik dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit u evidentua ulje e preferencës së studentëve për këtë degë studimi.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UT vë në dispozicion të studentëve informacion të nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin përmes informacionit nga departamenti në bashkëpunim me strukturat mbështetëse të FGJH-së.</p> <p>Në çdo fillim viti akademik organizohet “Java e orientimit” ku veçanërisht studentët e rinj njihen me stafin, ambientet dhe detyrimet e tyre.</p> <p>Evidenca nr 5.53, Broshura informuese.</p> <p>Në shërbim të përparimit akademik studentet njihen me orarin mësimor, strukturën e vitit akademik, sezonin e provimeve përkatëse, përmbajtjet e silabuseve, literaturën, format e vlerësimit.</p> <p>Evidenca nr.5.4, Rregullore e UT-së, neni 33.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik Institucioni lejon mundësinë e informimit të studentëve në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p>Evidenca nr.5.4, Rregullore e UT-së, neni 33</p> <p>Në programin e studimit “Gjuhë - letërsi dhe qytetërim turk” studentët njohës të mëparshëm të gjuhës turke asistohen nga pedagogët për zhvillim më të zgjeruar të potencialit të tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UT ka të përcaktuar në rregulloren e saj procedurat dhe kriteret në lidhje me vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve.</p> <p>Informimi i tyre realizohet periodikisht, në fillim të vitit akademik në provimet e ndërmjetme dhe në provimet finale.</p> <p>Kriteret e vlerësimit janë të publikuara në silabuse. GVJ vërejt se studentët njiheshin me tezën e provimit pas korigjimit të saj dhe kishin të drejtë ankimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit janë të parashikuara në rregulloren e UT, si dhe në rregulloren e departamentit.</p> <p>Studentët diplomantë udhëzohen nëpërmjet takimeve informuese me përgjegjësin e departamentit, sekretarinë mësimore dhe koordinatorin e programit të studimit.</p>

	Studentët që kryejnë këtë programin studimi diplomohen vetëm me provim diplome. <i>Për sa më sipër GVJ rekomandon për studentë me mesatare mbi 8 mbrojtjen e diplomës përmjet punimit të diplomës.</i>						
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në çdo fillim viti akademik dhe periodikisht UT organizon takime të hapura për informimin e studentëve të interesuar për programet e studimit. Organizohet “Java e orientimit” ku veçanërisht studentët e rinj njihen me stafin, ambientet dhe detyrimet e tyre, takime për këshillim karriere, fushatë informuese për maturantët, panairë pune, komunikime mediatike. <i>Njoftime {https://fgjh.edu.al}</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	UT shpërndan për studentët informacion të plotë në lidhje me strukturën ,organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, (<i>Evidenca Statuti i UT, i aksesueshëm edhe online https://unitr.edu.al</i>). Falë edhe komunikimit online ka një menaxhim të mirë të informacionit lidhur me çdo program. Nga bisedat me studentët u konfirmua se niveli i ofrimit të shërbimeve dhe dokumentacioni që marrin nga sekretaritetë mësimore është i plotë. Studentët kishin informacion lidhur me format e kontrollit të dijeve si testimet ndërmjetëse, detyrat e kursit, ushtrimet në laborator, apo provimet e formimit. Lidhur me këto detaje studentët informohen kryesisht nga pedagogët në orën e parë të modulit, por informacioni është gjithashtu i përhershëm në faqen web të universitetit (www.unitr.edu.al). Studenti informohet për sa më sipër përmes burimeve të ndryshme: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Programit të moduleve ➤ Komunikimit të pedagogut të modulit ➤ Portalit e-Studenti. ➤ Faqes online të FGJH dhe DGJSLLB/ST.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në rregulloren e programit të studimit, përcaktohen procedurat e provimit të formimit, bazuar në programin e provimit të formimit, i cili u vihet në dispozicion studentëve përmes sekretarive përkatëse, në fillim të vitit akademik. Studenti përgatitet për provimin e formimit, bazuar në fondin e pyetjeve dhe lëndëve që përfshihen në provim dhe ka të renditur një listë me tituj të punëve kërkimore që mund të zgjedh.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni u verifikuan aktivitetet e ndërmarra në kuadër të promovimit të programit të studimit në shkollat e mesme (<i>Evidenca nr 5.10- Kalendar i veprimtarisë, pdf</i>) ku janë shpërndarë materiale të ndryshme informuese. UT ka përgatitur një guidë të plotë të strukturës, programeve të studimit, shërbimeve dhe mundësive të punësimit të studentëve, module orientuese për studentët drejt procesit dhe hyrjes dhe gjetjes së tregut të punës., që u bëhet prezent studentëve të rinj me fillimin e studimeve në këtë universitet. Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka si objekt kryesor gjithëpërfshirjen e studentëve me aftësi ndryshe në jetën studentore, në bashkëpunimet me institucionet dhe për marrëveshje punësimi. Evidenca nr 5.71, Strategjia e gjithëpërfshirjes së studentëve me aftësi të kufizuara.</p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga bisedat me studentët u konfirmua se niveli i ofrimit të shërbimeve dhe dokumentacioni që marrin nga sekretaritet mësimor është i plotë. Studentët kishin informacion lidhur me format e kontrollit të dijeve si testimet ndërmjetëse, detyrat e kursit, ushtrimet në laborator, praktika profesionale apo provimet e formimit. Lidhur me këto detaje studentët informohen kryesisht nga pedagogët në orën e parë të modulit, por informacioni është gjithashtu i përhershëm në faqen web të universitetit. <i>Nga biseda me studentët GVJ konfirmon mungesën e koordinorit të studentit, si rrjedhojë rekomandojmë ST zgjedhjen e tij për periudhe afatshkurtër.</i></p>		
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit, përmes komunikimit të drejtpërdrejt nga administrata e fakultetit mundësohet edhe nga faqja e webit të fakultetit, rrjeteve sociale. Në dispozicion të studentëve që kanë fituar statusin e student komunikimi bëhet edhe nëpërmjet platformës, Teams platformës online e-student.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X


<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>UT dhe njësi bazë përkatëse për zhvillimin e programit të studimit disponojnë statistika të plota vjetore të studentëve, për numrin e studentëve dhe të diplomuarve (<i>Evidenca nr5.23 Tabela përmbledhëse pdf</i>). Për vitin akademik <u>2018-2019: 44 studentë; 2019-2020: 10 studentë; 2020-2021: 35 studentë.</u></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Të dhënat në FGJH ruhen në regjistra të tri formave për studentët, paraprak, themeltar, të arritjeve të studentëve dhe regjistrin për lëshimin e diplomës. Këto të dhëna ruhen dhe përpunohen nga sekretaritë mësimore, sipas rregullores së Sekretarisë mësimore, [Evidenca 5.83].</p> <p>Informacionet ruhen me shkrim dhe në formë elektronike sipas statutit të UT, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave vetjake.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas rregullores sekretaritë mësimore kanë për detyrë të zbatojnë plotësimin e evidencave standarde sipas kërkesave dhe afateve të kërkuara nga MASR apo UT. Hartohen raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje. Në dy vitet e fundit vërehet numër më i madh studentësh të diplomuar krahasimisht me studentë të regjistruar vitin e parë akademik. Ky fakt duhet parë si tregues i rënies së numrit të studentëve si rrjedhojë GVJ rekomandon forcimin e punës në mbështetje të promovimit të DGJSLLB/ST si departament i vetëm në vend që ofron mësimin e gjuhës dhe kulturë turke.</p> <p>Tri vitet e fundit rezultojnë që për këtë program nuk ka ripranime, apo çregjistrime.</p> <p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi, të cilat mund të gjenden në disa dokumente si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Regjistri Themeltar i Studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UT ➤ Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në UT, sipas programeve të studimit. ➤ Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, është dokumenti që vërteton diplomimin e tyre prej UT. <p>Të dhënat ruhen edhe në formë elektronike.</p> <p>Sekretaritë mësimore plotësojnë evidenca standarde, që ruhet në sekretarinë mësimore. Fakulteti disponon regjistrin e arritjeve akademike dhe diplomave me të dhënat:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Nunri i diplomës ➤ Lista e notave <p>Këto të dhëna menaxhohen nga sistemi i brendshëm i informacionit të Sekretarisë së Fakultetit.</p> <p>Informacioni në lidhje me diplomimin, listën e notave dhe suplementin e diplomës ruhet në regjistrin e arritjeve akademike dhe atë të diplomave, i cili, në përfundim të diplomimit, depozitohet në Arkivën e Shtetit dhe një kopje e njëzuar me origjinalin ruhet në arkivën e UT-së.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë</p>	<p>Statistikat mbi ecurinë e studentëve të programit mbahen në sekretaritë mësimore në tri modele: Regjistri Themeltar i Studentëve,</p>



<p>zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UT, Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo studenti regjistruar në UT, sipas programeve të studimit, Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, është dokumenti që vërteton diplomimin e tyre prej UT.</p> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u konstatua informacioni lidhur me regjistrimin, ecurinë dhe daljen e studentëve (<i>Evidenca nr5.7, Rregullore e sekretarisë mësimore</i>)</p> <p>Të dhënat mblidhen, përpunohen dhe vihen periodikisht në dispozicion të departamentit (<i>Evidenca nr5.7-Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf</i>). U konfirmua gjithashtu se të dhënat në procesverbale dhe në regjistrin e studentit, të cilat ruhen në sekretari në formë manuale.</p> <p>Për këtë program studimi nuk ka transferimeve, numri i e l nga programi i studimit bachelor është minimal.</p> <p><i>GVJ rekomandon aplikimin e regjistrave elektronikë.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të verifikueshme nga personat e autorizuar. Këto të dhëna menaxhohen nga sistemi i brendshëm i informacionit të Sekretarisë së Fakultetit.</p> <p>Informacioni në lidhje me diplomimin, listën e notave dhe suplementin e diplomës ruhet në regjistrin e arritjeve akademike dhe atë të diplomave, i cili, në përfundim të diplomimit, depozitohet në Arkivën e Shtetit dhe një kopje e njësuar me origjinalin ruhet në arkivën e UT-s.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti analizon periodikisht performancën e studentëve në përfundim të çdo viti akademik, ku përfshihen analiza për numrin e studentëve të regjistruar, çregjistruar, studentë që fitojnë bursë, të diplomuar etj. Të dhënat bëhen pjesë e raportimeve vjetore në UT.</p> <p>Evidenca nr. 5.10 Rregullore e Zyrës së Karrierës.</p> <p>Institucioni disponon një listë punësimi të studentëve të diplomuar, por prej saj nuk është e qartë se cilës periudhë diplomimi i takojnë. Gjurmimi nuk është periodik, si rrjedhojë tabela e të dhënave dhe cilësisë së punësimit nuk është e plotë.</p> <p><i>Për rrjedhojë, GVJ rekomandon përmirësimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me punësimin e të diplomuarve të këtij programi specifik studimi dhe mbështetje insitucionale, si departamenti i vetëm në vend që ofron mësimin e gjuhës dhe kulturës turke.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë përfshia dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse (Këshilli Studentor, Senat, Bordi i Administrimit dhe komisionet e përhershme) është në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet e tjera nën ligjore (<i>Evidenca nr 5.1 1.1-Statuti i UT; neni 125, 129</i>).</p> <p>Sipas statutit të UT studentët kanë të drejta përfaqësimi në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik • Këshillin e Etikës • Këshillat studentorë • Komisionet e përhershme <p>Studentët përfaqësues në SA dhe Komisionet <i>ad hoc</i> përfshihen në mënyrë aktive në vendimmarrjet në lidhje me procesin mësimor dhe më gjerë.</p> <p>Evidenca nr. 5.75, Rregullore e Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentin.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe se në dispozicion të tyre ka informacion të mjaftueshëm lidhur me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit Funksionimi i kërkesave të këtyre rregulloreve u konfirmua nga takimi me një grup studentësh të programit të studimit. Ndërkohë, planet mësimore u pa të ishin të afishuara në ambientet e UT dhe po ashtu, mund të shkarkoheshin në çdo kohë në faqe web të universitetit. Sistemi</p> <p>Studentëve u është shpërndarë informacioni i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet orarit mësimor. Studentët informohen për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor përmes sekretarive përkatëse Ky informacion u konfirmua nga studentët gjatë takimit që pati GVJ.</p> <p><i>Nga takimet me studentët , GVJ konstatoi se ata nuk ishin në dijeni për përfaqësitë e tyre në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik • Këshillin e Etikës • Këshillat studentorë • Komisionet e përhershme <p><i>dhe nuk ishin në dijeni të zgjedhjeve për anëtar senati.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Nga vizita në zyrat e ndryshme, veçanërisht sekretarinë mësimore të FGJH-së, u verifikuan format dhe dokumentacioni që shërben për informimin e studentëve lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p>Hartimi dhe ndryshimi i programit të studimit, realizohet duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve brenda dhe jashtë auditorit , duke bërë shpërndarje të rregullt për secilën lëndë sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p> <p>Njohja e studimeve të mëparshme është e parashikuar në Statut dhe Rregulloren e UT-së.</p> <p>Ndryshimet në plan bëhen duke respektuar ngarkesën maksimale të orëve në javë.</p> <p>Përmbajtja e planit mësimor lejon mobilitetin e studentëve me bursa Erasmus + të tipit vjetore ose të pjeshme.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Për rastin e mobiliteteve ka evidenca të posacme dhe procedura të njohjes së studimeve njësimave përmes sekretarisë dhe platformës e-student.</p> <p>Evidenca 5.74, Mobilitete 2016-2022.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët janë pjesë e komisioneve të përhershme dhe kanë të drejtë të japin mendime e të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës.</p> <p>Programi i studimit organizohet duke marrë në konsideratë aftësitë e studentëve për të përvetësuar sa më mirë njohuritë. Vlerësimi i ngarkesës akademike të studentit bëhet mbi bazën e informacionit teorik dhe praktik. Ngarkesa është e shpërndarë në mënyrë të përballeshme në semestra gjatë ciklit të studimit.</p> <p>Sugjerimet e studentëve merren në nivel departamenti për secilin program studimi. Ato realizohen nëpërmjet pyetësorëve, kërkesave/ankesave etj. Të dhënat që dalin nga pyetësorët përpunohen nga NJBSC dhe shërbejnë si bazë diskutimesh e reflektimesh për programe apo lëndë të caktuara me qëllim përmirësimin e procesit akademik.</p> <p><i>GVJ sugjeron që raportin vjetor të aktivitetit akademik të cilin UT e paraqet pranë MASR dhe publikon t'ua bën të ditur edhe studentëve, me qëllim përfshirjen e tyre në analizë.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>UT ka si objektiv plotësimin e standardeve lidhur me ngarkesën mësimore të studentëve, por dokumentimi i përfshirjes së studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit nuk është i plotë. Raporti i vlerësimit të brendshëm është shterues në lidhje me angazhimin real të studentëve në procesin e vendimmarrjes, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> <p>Departamenti kryen anketime të studentëve për marrjen e opinionit të tyre mbi ngarkesën akademike dhe mësimore. Gjithashtu në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi, si dhe pyetësori online për vlerësimin e aktivitetit mësimor kërkimor ku vlerësohet edhe puna e strukturave ndihmëse (<i>Shtojca 3.02]-raporte dhe analiza të departamentit.</i></p> <p>UT ka hartuar një sërë dokumentesh që mundësojnë sigurimin e barazisë, vlerësimit dhe kontrollit, si regjistri fizik, pasqyra e vlerësimit të studentit, hedhja e të dhënave për vlerësimin e studentit në sistemin e-student , ku student para hyrjes në provim mund të shikojë vlerësimin gjatë vitit.</p> <p>Pas periudhës së parashikuar në rregullore, s nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.</p> <p>Evidenca nr. 5.4 Rrëgjillore e IAL, nenet 49,50,51.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në rastet e ankimimit, procedura, si dhe vendimi i marrë të regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në Departament ose në Dekanat.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi V.6


Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve.</p> <p>UT ka Drejtorinë e Informimit të Studentëve dhe Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i marrëdhënieve me studentët, Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Sekretaritetë mësimore dhe Kujdestarin e studentit, të cilat orientojnë të rinjtë sipas nevojave të tyre, në procese të ndryshme të jetës studentore përgjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p>Zyra e kujdesit studentor/Karrierës/Alumnit angazhohet në ndihmë të studentëve me informacione të nevojshme për programin që ndjekin. Nga departamentet studentë këshillohen dhe asistohen nga kujdestari për vështirësitë që hasin për përvetësimin lëndëve apo përmbushjen e detyrimeve akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të studentëve janë Sektori i marrëdhënieve me studentët, Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Sekretaritetë mësimore të cilat asistojnë dhe ndjekin studentët edhe pas kohës së studimeve.</p> <p>UT ka në dispozicion të studentëve faqen e web-it të UT-s e cila është e aksesueshme nga të gjithë në çdo kohë.</p> <p>Vendimet e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, Rektorati dhe Dekanati në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, etj., u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të Universitetit, njoftimeve në faqen elektronike etj.</p> <p>Informimit të studentëve për mundësitë e punësimit i shërben organizimi i përvitshëm i panairëve të karrierës.</p> <p>Qendra e karrierës dhe alumni kanë ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UT, me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në 5 vjet, por ndërtimi i portalit interaktiv të QKA është në fazat fillestare.</p> <p>Dokumente të tilla si, regjistri i pedagogut, pasqyra e vlerësimit të të dhënave, dhe procedura e ankimit, e cila nga intervistat me studentët rezultoi funksionale, bëjnë të mundur rritjen e cilësisë dhe ndihmesë të plotë në funksion të çështjeve shqetësuese për studentët</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione</p>	<p>UT /FGJH u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni e cila ka ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UT, me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në pesë vjet (<i>Evidenca nr. 6.10 Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i>).</p> <p>Zyra është e pajisur me stafin dhe facilitetet e nevojshme. Studentët orientohen lidhur me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin e praktikës profesionale dhe veçanërisht orientimin në tregun e punës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra përgatit material informuese për studentët e rinj dhe i orienton ata për mundësitë e transferimit të krediteve të studimit, apo transferimit të programeve të studimit, si edhe për mundësitë e kryerjes së praktikave profesionale dhe të punësimit. <i>Nga takimi i GVJ-së me dekanen e fakultetit, drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik, konstatohet konkurrencë e fortë nga programe të tjera studimi të përafërta, më të pëlqyeshme midis të rinjve, të ofruara nga vetë FGJH, Universiteti i Tiranës.</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni krijon mundësi lidhëse studentëve me tregun e punës, duke krijuar kontakte me punëdhënës potenciale. Zyra mban kontakte me të diplomuarit dhe përditëson bazën e të dhënave në lidhje me punësimin. Nga komunikim me studentët u dallua se lidhja e tyre me Alumni ishte e pothuajse e panjohur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UT ka hartuar dhe miratuar një seri dokumentesh në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Cilësisë si dhe një sërë strukturash për sigurimin e cilësisë. UT harton politikat dhe procedurat, referuar cilësisë identifikojmë, Rregullore për sigurimin e cilësisë dhe manuali e cilësisë (<i>Evidenca 6.6, neni 5,6</i>), të cilat miratohen nga SA. UT ka hartuar një plan strategjik 4 vjeçar (<i>Evidenca 6.42 Programi i transparencës në UT</i>) ku përshkruhen politikat dhe praktikat që ndjek ky institucion për garantimin dhe rritjen e cilësisë së veprimtarisë së tij të gjithanshme.

	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë objektiva të shprehura qartë dhe konfirmohen edhe në strategjinë e institucionit (<i>Evidenca 6.1, fq. 4 Strategjia e UT-së.pdf</i>) UT ka hartuar dhe miratuar gjithashtu manualin e cilësisë (<i>Evidenca - Manual i cilësisë UT 6,22.pdf</i>), që përcakton parimet dhe strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë në institucion.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>FGJH ka në përbërje të strukturës së tij Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) që ka përfaqësues nga çdo departament (<i>Shtojca 3.07-Të dhëna për NjSBC.pdf</i>). nga DGJSLB/ST në ndihmë të njësisë janë të angazhuar 3 pedagogë me kohë të plotë dhe 1 student, të përmes punës së vazhdueshme zbatojnë strategjinë institucionale për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Strukturat e ngritura janë funksionale. GVJ u njoh mepyetsorine studenteve, ku bëhen vlerësime për lëndët mësimore dhe pedagogun. Kjo procedurë zhvillohet dy herë në vit, on-line dhe në mënyrë anonime.</p> <p><i>Statistikisht pjesëmarrja e studentëve ishte në masën 50%, i cili vlerësohej si i mjaftueshëm për matjen e punës së pedagogut dhe cilësisë së saj.</i></p> <p><i>Për Sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave ka vullnet dhe përpjekje që NJSBC të strukturohet edhe në nivel departamenti.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UT realizohet përmes procesit të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Në raport evidentohet marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe që lidhen me programet e studimit që ofron ST.</p> <p><i>Evidenca 6.20, Evidenca 6.28.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>NJSB monitoron analizat dhe vlerësimin e proceseve akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve përkatëse. Gjithashtu, kjo zyrë përgatit në mënyrë të përvitshme analizën e veprimtarisë mësimore të FGJH/UT dhe ia referon atë Senatit Akademik.</p> <p>Në përfundim të analizave reflektohet me rekomandime dhe detyra për procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies dhe propozohen masa përmirësuese.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik organizohet rishikim periodik i programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij, ku fokusi kryesor janë elementët përbërës të moduleve dhe kreditet, baza e nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, literatura e përdorur, procedurat e kontrollit të dijeve/provimeve dhe analizës së rezultateve të kontrollit. Gjatë këtij merret në konsideratë dhe mendimet e studentëve përmes anketimeve që kryhen.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësisë të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Me qëllimin shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë UT ka ngritur në nivel universitar dhe në nivel fakulteti Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në përbërje të drejtorisë së kurrikulave, sigurisë së cilësisë dhe kërkimit shkencor, si dhe ekipe të vlerësimit të brendshëm, të cilat në bashkëpunim me Drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, me administratorët e fakulteteve, Këshillin studentor kanë përgjegjësi për të identifikuar probleme, nisma, çështje të cilësisë dhe rishikimit të programeve edhe të nivelit të parë. (Evidenca -Manual i cilësisë UT neni 12.pdf) (Evidenca 6.1, fq. 4 Strategjia e UT-së.pdf)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Ndryshimet e kurrikulës së programit të studimit realizohen sipas një procedure, të përcaktuar në manualin e cilësisë së UT (Evidenca 6.6 pika 3.1-Manuali i cilësisë UT.pdf). Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me praktikën konkrete të ndryshimeve në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë-letërsi turke” (Evidenca 6.4 Rregullore e DGJSLLB/ST pdf). Ndryshimet e bëra dhe procedura e ndjekur ruhen në dosjet përkatëse të arkivës së FGJH-s dhe në Drejtorinë e Kurrikulave UT.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe të ngarkuar rezulton se institucioni përdor procedura të dokumentuara për shqyrtimin dhe vlerësimin e ecurisë deh mbarëvajtjes së programeve të studimit. Vlerësimi i programeve të studimit kryhet në mënyrë periodike çdo 3 vjet nga grupi shkencor i programit. ,duke iu përmbajtur “Manualit të Cilësisë”.</p> <p>Dokumente të tilla si, regjistri i pedagogut, pasqyra e vlerësimit të të dhënave, dhe procedura e ankimit, e cila nga intervistat me studentët rezultoi funksionale, bëjnë të mundur rritjen e cilësisë dhe ndihmesë të plotë në funksion të çështjeve shqetësuese për mbarëvajtjen e ecurisë së programit.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultat e vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve, së pari drejtuesit të njësisë bazë, dekanatit, NJSBC, Drejtorinë e Kurrikulave UT.</p> <p>Dekapati i FGJH-s përcakton kalendarin dhe grafikun konkret të vlerësimit të lëndëve. Analiza realizohet nga grupi shkencor i ngritur pranë departamentit për këtë qëllim, ndërsa analiza e vlerësimit ndërmerret nga palë neutrale. Evidencat 6.26, 6.41, 6.42.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë gjithë personelin akademik ,ndihmës akademik dhe administrativ. Detajet dhe procedurat paracaktohen nga përgjegjësi I departamentit.</p> <p>Vlerësimi kryhet nga studentët dy herë gjatë vitit akademik dhe nëpërmjet pyetësorit merret informacion i përditësuar për ecurinë e procesit mësimor, shkallës e cilësisë së mësimdhënies, kontekstin</p>

	lëndor, duke krijuar hapësirën e mundshme për përmirësimin e procesit mësimor në hallkat e tij përbërëse. Bazuar në raportin përmbledhës të pyetësorit studentor të konfirmuar edhe nga biseda me GVB 50% e numrit të studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor <i>GVJ gjykon se kjo pjesëmarrja e studentëve në këtë anketim e bën pak të besueshëm gjykimin e punës në tërësinë e saj.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) e ngritur në çdo njësi kryesore është përgjegjëse për vlerësimin e programeve të studimit (<i>Evidenca 6,6-Rregullore për sigurimin e cilësisë UT, neni27.pdf</i>). Vlerësimet bëhen në përputhje me kriteret, kërkesat dhe procedurat e parashikuara në manualin e cilësisë (<i>Shtojca 1.16-Manual i cilësisë UT</i>) Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit dhe i cilësisë së mësimin kanë qenë objekt konstant i analizave vjetore të Seksionit të Gjuhës Turke , në përgjigje të vetëvlerësimit të brendshëm periodik.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimin, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Vlerësimi institucional i realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit dominohet nga metodat të drejtpërdrejta të vlerësimin. GVB pranë departamentit të DGJSLIB/ST kryhen vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë dhe në Rregulloren për sigurimin e Cilësisë UT. Informacioni konsultohet së pari në departament dhe i kalohet për njohje e personelit akademik dhe administrativ. Në vlerësimin e brendshëm përfshihet rishikimi i përvitshëm i kurrikulës deri në masën 20%, vlerësimet e lëndëve dhe performancën e pedagogut.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	Vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim dhe përmirësimi periodik i kurrikulës, analiza e procesit të mësimdhënies dhe e rezultateve të studentëve, apo analiza periodike e efektivitetit të praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve janë objekte të përhershme të analizave vjetore të departamentit përgjegjës për programin mësimor dhe vetë njësisë kryesore, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve. <i>GVJ rekomandon përfshirjen e praktikës në terren së paku me 6 kredite, në ndihmë të përmirësimin të rezultateve të pritshme nga programi.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e	Departamenti kryen analizën me NJSBC dhe Aluminin në të cilën identifikohet edhe numri i të punësuarve nga ky program studimi

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>dhe mundësitë e promovimit të këtij programi dhe pyetësor që në thelb sesa i nevojshëm dhe sa ndihmues ka qenë ky program studimi për karrierën e tyre.</p> <p>Nga takimi me dekanen konfirmojmë se UT është duke përgatitur manualin e performancës së stafit akademik, si instrument për vlerësimin e punës së pedagogut.</p> <p>Puna e stafit akademik i përcillet dekanes dhe përpunohet nga NJSBC.</p> <p>Në kuadër të shkëmbimeve me institucione të huaja zyra e dekanes konfirmon shkëmbim eksperience me 34 profesorë të huaj.</p> <p><i>GVJ rekomandon ngritjen e rrjetit Alumni në nivel departamenti me qëllim ndihmesën e tyre në bashkëpunime për realizimin e objektivave të programit, vecanërisht promovimit sa më efektiv të tij.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="619 638 774 705">Përmbushet plotësisht</td> <td data-bbox="774 638 981 705">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="981 638 1189 705">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1189 638 1396 705">Nuk përmbushet</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td align="center">X</td> <td></td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Nuk përmbushet			X	
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Nuk përmbushet						
		X							

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UT përmbush këtë standard, nëpërmjet përfshirjes së njësisë akademike, personelit dhe studentëve në proceset e VBC- së programeve të studimit dhe informimit të palëve të interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra.</p> <p>GVJ konstatoi praninë e strukturave të posaçme për sigurimin e cilësisë dhe shfrytëzimin prej tyre të manualit të cilësisë, rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse studimit (<i>Evidenca 6,6-Rregullore për sigurimin e cilësisë UT, neni 27</i>). Vlerësimet bëhen në përputhje me kriteret, kërkesat dhe procedurat e parashikuara në manualin e cilësisë (<i>Shtojca 1.16-Manual i cilësisë UT</i>).</p> <p>Në rregulloren e përgjithshme, në rregulloren e Fakultetit, dhe në manualin e sigurimit të cilësisë specifikohen detyrat dhe modalitetet e angazhimit të strukturave të ndryshme të të gjitha niveleve.</p> <p>Përfshirja e ST materializohet në raportet respektive vjetore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë të UT janë përcaktuar qartësisht përgjegjësitë dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në raport lexohet qartazi përcaktimi i detyrave dhe hierarkisë dhe autonomisë operative për garantimin dhe ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 6.6, neni 27, 30.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit është e garantuar përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi angazhimin e plotë të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në diskutimet për sigurimin e cilësisë së programit. Ata kanë qenë pjesë e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në mbledhjet e departamentit dhe Fakultetit, apo përgjigjeve ndaj pyetësorëve që adresojnë çështje të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</i> <i>Evidenca Manual i cilësisë UT.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit dhe performancës e pedagogëve është një proces tërësisht ligjor dhe që respekton maksimum integritetin njerëzor dhe akademik të çdo individi dhe shmang maksimalisht çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik e jo akademik dhe studentëve.</p> <p>GVJ konfirmon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit në vlerësimin e brendshëm të cilësisë tij. Praktikisht studentët janë pjesë e qeverisjes së Universitetit të Tiranës, nëpërmjet prezencës së përfaqësuesve të tyre në Senat, Komisionin e përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Këshillin studentor dhe Komisionin e etikës.</p> <p>Konkretisht studentët e ST-së nuk ishin plotësisht të përfshirë dhe të njohur me strukturat e cituara më sipër, por ata shprehin opinionet e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet angazhimit periodik në anketimet studentore.</p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë komunikimeve me dekanen, GVB-në dhe stafin akademik u konfirmua strategjia për tërheqjen e bashkëpunëtorëve , apo ekspertëve të jashtëm për mendime të specializuara në lidhje me cilësinë e programit, por GVJ nuk mundi të dokumentojë përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm në sigurimin e cilësisë së programit dhe përmirësimin e tij.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm</p>	<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit bëhen publike dhe janë të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	aksesueshme nga i gjithë stafi akademik dhe ai ndihmës akademik i UT, përfshirë këtu edhe studentët. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të identifikuar për të reflektuar, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të këtyre rekomandimeve ngarkohet për zbatim stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. Studentët, stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, informohen dhe ndërgjegjësohen në mënyrë të vazhduar për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë.		
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, publikohen pjesërisht, por duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale nëpërmjet platformës e-studenti, faqes së web-saitit të njësive kryesore dhe vetë institucionit.		
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	U konfirmua prezenca e një sërë raportesh nga struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë; raporte të analizës vjetore të njësive bazë dhe raport i NJSBC për vitin akademik 2020-2021. Në raportet e analizave vjetore janë diskutuar gjetjet e strukturave të sigurimit të cilësisë dhe janë parashikuar masa për përmirësimin e problematikës së vërejtur lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.		
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Mbledhjet e departamentit, shërbejnë për njohjen me arritjet, mangësitë, problematikat dhe praktikat lidhur me sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore.		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet Qendrës së Trajnimeve është realizuar trajnimi i stafit kërkimin shkencor, për procesin e akreditimit dhe nga takimi me dekanen dhe GVB konfirmohet bashkëpunimi i vazhdueshëm i qendrës trajnimeve me njësitet kryesore dhe njësitet bazë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në gjuhë turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim” të institucionit të arsimit të lartë “ Universiteti i Tiranës ”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Programi i studimit është unik pra i vetëm si i tillë në universitetet shqiptare.
2. Ka vazhdimësi në programin e ciklit të dytë dhe ka përputhje të plotë me fushën akademike dhe shkencore të FGJH-së.
3. Përfshirja e stafit dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Stafi akademik zotëron kompetenca të shumëllojshme dhe bën përpjekje të vazhdueshme për kualifikim akademik.
5. Struktura përgjegjëse për realizimin e programit bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kurrikulës me nevojat dinamike të tregut të punës.
6. FGJH ofron infrastruktura fizike më se të përshtatshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe në përmbushje të objektivave të mësimdhënies.
7. Marrëdhënie të qëndrueshme dhe bashkëpunim i konsiderueshëm me Ambasadën Turke në Tiranë dhe Universitete turke për aktivitete shkencore dhe në organizimin e aktivitete të ndryshme dypalëshe me studentët.

Pika të dobëta


1. Preferencë e ulët e të rinjve për të studiuar në “Bachelor në Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim Turk, përkthim dhe interpretim”, **Referim, Standardi V.1, Kriteri VI.**
2. Nivel i ulët i punësimit të të diplomuarve në vende pune që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me programin e studimit. **Referim, Standardi V/4, Kriteri V.**
3. Konkurrencë e fortë nga programe të tjera studimi të përafërta, më të pëlqyeshme midis të rinjve, të ofruara nga vetë FGJH, Universiteti i Tiranës. **Referim, Standardi V.6, Kriteri III.**

Rekomandime

1. Të rrisë mbështetjen financiare për Departamentin e Gjuhëve Sllave Ballkanike, Seksioni i Gjuhës turke në funksion të thellimit të aktivitetit të tij kërkimor dhe paralelisht me të nxitjen dhe promovimin e publikimeve të stafit akademik në periodikë shkencorë të listuara në database të identifikuara për thellësinë dhe seriozitetin e kërkimit shkencor, si dhe aplikimin në projekte të ndryshme të financuara nga AKSHI, apo nga organizma të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.



2. Zgjerimin e kontakteve me institucione publike e jopublike, biznese, në funksion të zgjerimit të mundësive për aftësim të vazhdueshëm të studentëve, përditësimin dhe përmirësimin e studimeve për tregun e punës.
3. GVJ sugjeron futjen e një lënde për praktikë mësimore në mënyrë që studentë të kenë mundësi kontakti me tregun e punës.
4. Të shikohet mundësia e ngritjes së një Bordi këshillimor me partnerë strategjikë për tregun e punës në nivel fakulteti.
5. GVJ sugjeron zhvillimin e trajnimeve profesionale dhe një kontakt më të ngushtë me tregun e punës.
6. Të shtojë përpjekjet për hapjen e programeve të përbashkëta me universitete të huaja, në dobi të prirjeve bashkëkohore, që arsimit i lartë ka sot në Republikën e Shqipërisë, për zhvillime të reja dhe konkrete, për mundësi zhvillimi dhe rritjen e ofertës së punësimit për studentëve.
7. Të shikohet prania afatgjatë e një lektori të huaj, si mbështetje pozitive për realizimin e objektivave formuese të programit të studimit.
8. Rekomandojmë që Departamenti i Gjuhëve Sllave Ballkanike, Seksioni i Gjuhës turke të krijojë me tepër marrëdhënie të drejtpërdrejta me Alumni-n për të kuptuar problematikën e rënies së numrit të studentëve në mënyrë, që të rimerret vijueshmëria dhe të rritet numri i maturantëve, që për zgjedhin këtë program studimi.
9. Rekomandojmë organizimin e Departamentit të Gjuhëve Sllave Ballkanike, Seksioni i Gjuhës turke në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor.
10. GVJ rekomandon që strukturat përkatëse të angazhohen më shumë për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas të programit, përmbajtjes e objektivave të tij pranë institucioneve shtetërore e private, si dhe shoqërisë civile, për të krijuar më shumë kushtet për akses punësimi pranë tyre, duke argumentuar rëndësinë e nevojën e ekspertëve në këtë fushë.
11. GVJ sugjeron rritjen e numrit të partneriteteve dhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve përmes projekteve evropiane të shkëmbimit Erasmus + dhe të tjera të ngjashme.
12. Faqja web e departamentit është jashtë funksioni: <https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-sllavo-ballkanike/>
13. GVJ sugjeron aktivizimin e faqes në mënyrë që të aksesohet sa më lehtë informacioni rreth departamentit dhe programit të studimit, siç mund të jenë rubrika e stafit dhe aktivitetet e njësisë, si dhe departamenti të jetë aktiv në rrjetet sociale, si një mundësi e mirë e marrëdhënieve me publikun e interesuar, e sidomos për kandidatët për student në këtë program studimi.



Conclusions of the evaluation of the first cycle study program "Bachelor in Turkish language with profiles; Turkish language, literature and civilization, translation and interpretation" of the higher education institution "University of Tirana"

Strengths and Affirmations


1. The study program is unique, i.e. the only one of its kind in Albanian universities.
2. There is continuity in the program of the second cycle and it is fully compatible with the academic and scientific field of FGjH.
3. Involvement of staff and students in national and international projects.
4. The academic staff possesses diverse competencies and makes continuous efforts for academic qualification.
5. The structure responsible for the implementation of the program makes continuous efforts to improve the curriculum with the dynamic needs of the labor market.
6. FGjH offers more than adequate physical infrastructure for the smooth running of the study program and the fulfillment of teaching objectives.
7. Stable relations and considerable cooperation with the Turkish Embassy in Tirana and Turkish Universities for scientific activities and in the organization of various bilateral activities with students.

Weak points


1. Low preference of young people to study in "Bachelor in Turkish Language with profiles; Turkish language, literature and civilization, translation and interpretation", **Reference, Standard V.1, Criterion VI.**
2. Low level of employment of graduates in jobs directly related to the study program. **Reference, Standard V/4, Criterion V.**
3. Strong competition from other similar study programs, more popular among young people, offered by FGjH itself, University of Tirana. **Reference, Standard V.6, Criterion III.**

Recommendations

1. To increase the financial support for the Department of Balkan Slavic Languages, the Section of the Turkish Language in order to deepen its research activity and in parallel to encourage and promote the publications of the academic staff in scientific periodicals listed in databases identified for the depth and the seriousness of scientific research, as well as the application in various projects financed by ANA, or by other national and international organizations.
2. Expanding contacts with public and non-public institutions, businesses, in order to expand opportunities for continuous training of students, updating and improving studies for the labor market.
3. GVJ suggests the introduction of a subject for teaching practice so that students have the opportunity to contact the labor market.



4. To consider the possibility of setting up an advisory board with strategic partners for the labor market at the faculty level.
5. GVJ suggests the development of professional training and a closer contact with the labor market.
6. To increase the efforts for the opening of joint programs with foreign universities, for the benefit of the contemporary trends that higher education has today in the Republic of Albania, for new and concrete developments, for development opportunities and the increase in the employment offer for to the students.
7. To see the long-term presence of a foreign lecturer as positive support for the realization of the formative objectives of the study program.
8. We recommend that the Department of Balkan Slavic Languages, the Turkish Language Section establish more direct relations with the Alumni in order to understand the problem of the decrease in the number of students in order to regain continuity and increase the number of graduates, that select this study program.
9. We recommend the organization of the Department of Balkan Slavic Languages, the Turkish Language Section in teaching groups and in permanent or temporary research-scientific groups.
10. GVJ recommends that the relevant structures engage more to find the right forms for a more efficient promotion and marketing of the program, the content of its objectives near state and private institutions, as well as civil society, to create more conditions for employment access to them, arguing the importance and need of experts in this field.
11. GVJ suggests increasing the number of partnerships and mobility of academic staff and students through European exchange projects Erasmus + and other similar ones.
12. The website of the department is out of order: <https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-sllavo-balkanike/>
13. GVJ suggests the activation of the page so that information about the department and the study program can be accessed as easily as possible, such as the staff column and the activities of the unit, as well as the department being active on social networks, as a good possibility of relations with the interested public, especially for student candidates in this study program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen plotësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

